

1 E martë, 18 tetor 2022

2 [Konferencë Përgatitore për Gjykim]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 09.00

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Uluni, ju lutem.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dhomat e Specializuara  
9 çelin seancën.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Mirëmëngjes, mirë se vini në këtë Konferencë të Përgatitjes së  
12 Gjykimit. Tani do t'ia jap mundësinë disa fotografëve që të  
13 bëjnë fotografi.

14 Faleminderit. Sekretaria, lajmëroni numrin e lëndës, ju  
15 lutem.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
17 Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i  
18 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit znj. Sekretare.

21 Përpara se t'u kërkoj të pranishmëve që të paraqesin  
22 veten, dua t'u kujtoj të gjithëve disa rregullave të cilat do  
23 të duhet që t'i ndjekim gjatë të gjithë kohës. Ju lutem,  
24 përpara se të flisni, ju lutem hapni mikrofonin dhe ta  
25 mbylleni porsa të mbaroni. Kemi përkthim në gjuhën shqipe dhe

1 serbe kështu që flisni ngadalë dhe qartë. Dhe përpara se të  
2 ndërhyjni prisni pesë sekonda për t'u lejuar përkthyesve që të  
3 përfundojnë përkthimin e fjalisë së mëparshme. Kjo është e  
4 vështirë për ta ndjekur, prandaj, ju lutem, ta mbani parasysh  
5 për ndryshe do të ketë mbivendosje të fjalëve dhe kjo është  
6 problem shpesh.

7 Dua t'ju kujtoj palëve, Mbrojtjes së Viktimave dhe Zyrës  
8 Administrative që ka disa informacione të cilat janë të  
9 mbrojtura. Ky informacion i mbrojtur nuk duhet të thuhet në  
10 seancë të hapur dhe do t'ju kujtoj që të më lajmëroni  
11 paraprakisht në qoftë se kërkonit që të nxirrni informacione  
12 konfidenciale, me qëllim që të kalojmë në seanca të mbyllura  
13 apo private.

14 Dakord. Atëherë po ju kërkoj palëve, Mbrojtjes së  
15 Viktimave dhe Zyrës Administrative që të paraqesin veten e  
16 tyre dhe fillojmë me Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Ju e  
17 keni fjalën.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
19 Gjykatës, sot jemi të përfaqësuar nga Alex Whiting,  
20 Zëvendësprokurori i Specializuar, Eva Wyler, Guilia Bianchi  
21 dhe unë vetë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
23 Mbrojtësja e Viktimave, ju keni fjalën.

24 Z. LAWS: [Përkthim] [Nuk ka mikrofon] Ju kërkoj ndjesë  
25 është një gabim i hershëm. Jam Simon Laws, jam Mbrojtës i

1 Viktimave në këtë çështje dhe unë sot këtu kam Maria

2 Radziojowska, bashkëmbrojtëse.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit.

5 Pala Mbrojtëse.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] [Nuk ka mikrofon].

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

8 lutem hapni mikrofonin. Duhet që të mësoheni me këtë punë.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jam Jean-Louis Gilissen, nga  
10 Liezhi në Belgjikë. Jam folës i frëngjishtes megjithatë do të  
11 përpiqem në anglisht. Këtu kam z. Aouini, bashkëmbrojtës i  
12 dytë, z. Cariolou; dhe përgjegjëse e çështjes Dzeneta  
13 Petravice. Sot kemi me vete edhe dy stazhierë nga Universiteti  
14 i Parisit në Francë. Dhe me këtë është i plotësuar i tërë  
15 ekipi.

16 Faleminderit.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe  
18 për sa i përket procesverbalit, duhet të themi që klienti juaj  
19 është në sallën e gjyqit.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Po z. Shala është i  
21 pranishëm këtu.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
23 Shala, po ju kujtoj që të gjitha rregullat, të drejtat sipas  
24 Ligjit dhe Rregullores siç ju janë lexuar nga Gjykatësi i  
25 Procedurës Paraprake, vazhdojnë të jenë në fuqi edhe para

1 këtij Trupi Gjykues, përshirë të drejtën e heshtjes.

2 Tani i kthehem Zyrës Administrative. Ju e keni fjalën.

3 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëmëngjes, kolegë të nderuar,  
4 unë jam Jonas Nilsson nga drejtoria e Zyrës Administrative  
5 këtu.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
7 Faleminderit.

8 Kolegët e mi janë Gjykatësi Roland Dekkers, Gjykatësi  
9 Gilbert Bitti dhe Gjykatësi Vladimir Mikula. Dhe unë jam  
10 Mappie Veldt-Foglia dhe jam Kryegjykatëse e Trupit Gjykues I.

11 Tani do të paraqes një histori të shkurtër proceduriale  
12 dhe për të paraqitur seancën e ditës së sotme dhe për të  
13 paraqitur se cila është baza ligjore e saj.

14 Me datën 28 janar të këtij viti, ZPS-ja paraqiti dosjen e  
15 saj paragjyqësore. Me datën 29 qershor ZPS-ja e amendoi listën  
16 e dëshmitarëve të cilën e ka ndryshuar sërish me datën 10  
17 tetor dhe pastaj paraqiti listën e provave materiale. Me datën  
18 5 shtator pala Mbrojtëse paraqiti dosjen e saj paragjyqësore  
19 dhe na dërgoi një listë paraprake të dëshmitarëve. Dhe kemi  
20 nxjerrë një numër vendimesh me anë të së cilave kemi pranuar  
21 tetë viktime që do të marrin pjesë në këto procedura. Ato do  
22 t'i njohim me emrat 01/04 deri 08/04.

23 Me datën 15 shtator të këtij viti Kryetarja e Dhomave të  
24 Specializuara caktoi Trupin Gjykues I pas dërgimit të dosjes  
25 paragjyqësore nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe kjo ka

1 ndodhur me datën 21 shtator kur Gjykatësi i Procedurës  
2 Paraprake e dërgoi dosjen për gjykim përpara Trupit Gjykues I.

3 Me datën 30 shtator Trupi Gjykues nxori vendim lidhur me  
4 këtë konferencë për përgatitjen e gjyqit për datën e sotme,  
5 nesër dhe pasnesër dhe të premtën, ditë e mbajtur rezervë,  
6 përfshirë një seancë *ex parte*, të mbyllur. Në këtë vendim u  
7 kërkuam palëve, Mbrojtëses së Viktimave, Zyrës Administrative  
8 që të paraqesin mocione me shkrim lidhur me një numër çështjes  
9 me qëllim që të grumbullojmë informacione të cilat do të na  
10 mundësojnë të ndërmarim hapat e tjerë para fillimit të  
11 gjyqit.

12 I kemi marrë këto mocione me datën 10 tetor sipas  
13 kërkesës dhe i dhamë palës Mbrojtëse -- me datën 13 e kemi  
14 miratuar kërkesën e tyre për një seancë *ex parte*. Kjo përmes -  
15 - me vendim të datës 13 tetor të këtij viti në orën 16.05 me  
16 email të dërguar nga Trupi Gjykues I, Zyrës së Menaxhimit  
17 Administrativ, pra vendimi për mbajtjen e kësaj seance *ex*  
18 *parte*.

19 Cili është synimi i seancës së sotme. Sot dhe në ditët në  
20 vazhdim ne do të mbajmë atë që rregullat e procedurës e quajnë  
21 Konferencën e Përgatitjes së Gjyqit. Këto janë seanca ku  
22 Gjykatësi publik diskuton të gjithë informacionin e nevojshëm  
23 për të filluar gjykimin. Këtë do ta bëjmë së bashku me ZPS-në,  
24 Mbrojtjen, Mbrojtjen e Viktimave dhe Zyrën Administrative.

25 Pra, gjatë ditës së sotme ne sot nuk do të diskutojmë

1 fajin apo pafajësinë e të akuzuarit dhe nuk do të dëgjojmë  
2 asnjë dëshmi.

3 Për sa i përket planit të punës për ditët në vazhdim,  
4 Trupi Gjykues vëren se ka patur një ndryshim për sa i përket  
5 ditës -- seancës së nesër pasdite. Ne nuk do të mbajmë seancë  
6 në sesionin e pasdites nga ora 14.30 deri në orën 16.00.

7 Siç është paraqitur edhe në vendimin për mbajtjen e  
8 seancës, kjo konferencë do të ketë një seancë *ex parte* me ZPS-  
9 në, Zyrën Mbrojtëse dhe Zyrën e Mbrojtës së Viktimave. Dhe siç  
10 e kemi thënë do të mbajmë edhe një seancë *ex parte*, të mbyllur  
11 me palën Mbrojtëse.

12 Rendi i ditës për ditën e sotme është kështu. Së pari do  
13 të shqyrtojmë listën e çështjeve sipas vendimit. Do t'ju jepet  
14 mundësia që të bëni vëzhgimet shtesë dhe ne do të bëjmë edhe  
15 disa pyetje lidhur me një numër prej çështjeve të ngritura. Do  
16 t'ju jepet po kështu mundësia që të bëni komente të cilat i  
17 mendoni të domosdoshme dhe në fund ne do të nxjerrim një numër  
18 urdhrash gojor dhe do t'ju informojmë lidhur me disa nga  
19 vendimet që dëshiron të marrë Trupi Gjykues në periudhën në  
20 vazhdim.

21 Përpara se ta fillomë diskutimin, do t'ju kërkoja që të  
22 ndiqni rendin e ditës sipas vendimit që kemi nxjerrë dhe sa më  
23 shumë që të jetë e mundur të mos përsërisni ato të cilat i  
24 keni paraqitur tashmë me shkrim.

25 Pika e parë në rendin e ditës janë hetimet dhe nxjerrja e

1 provave.

2 Ne kemi kërkuar mocione nga Zyra e Prokurorit të  
3 Specializuar lidhur me këto çështje. Konfirmim nga ZPS-ja që  
4 janë përfunduar hetimet dhe nxjerrja e provave fajësuese. Kemi  
5 kërkuar po kështu lidhur me faktin nëse ZPS-ja kërkon që të  
6 nxjerrë prova të tjera shfajësuese sipas rregullës 103 të  
7 Rregullores dhe nën rregullën 102(3) të Rregullores dhe  
8 çështje të ndërlidhura.

9 Përpara se t'ju jap fjalën për të bërë parashtrime të  
10 tjera, z. Prokuror nëse keni të tilla, do të doja të kalonim  
11 në seancë private, pasi duam të diskutojmë diçka të cilën e  
12 kemi fshirë në dosjen tuaj të protokolluar.

13 Znj. Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

14 [Seancë private]

15 [Seancë private teksti i fshirë]

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
14 jemi në seancë publike.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Faleminderit

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me sa  
18 kuptoj unë dokumentet e përmendura në paragrafin 12 të  
19 parashtrimit tonë janë nxjerrë gjatë të premtes së shkuar. Dhe  
20 besoj që mund t'u jap edhe numrin e paketës së nxjerrjes, pra  
21 numri 87.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një  
23 koment tjetër. Ju falënderoj paraprakisht për informacionin që  
24 na jepni. A mund të na sqaroni më tej se përse janë nxjerrë  
25 tani dhe jo më herët? Unë besoj se kjo duhet të jetë një



1 yetje e ligjshme nga pala a Mbrojtjes

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, e nderuara Gjykatëse. Kur  
3 po i afrohem fundit të seancës -- të fazës paragjyqësore,  
4 ne vendosëm që të bënim një auditim të të tëra materialeve të  
5 nxjerra për të parë nëse ka pasur ndonjë dokument të reja që  
6 kemi siguruar dhe për t'u siguruar që i kemi nxjerrë të gjitha  
7 dokumentet në bazë të angazhimeve tona. Ne kemi parë kemi --  
8 kemi një numër dokumentesh të kufizuar disa prej të cilave  
9 janë nxjerrë vetëm kohën e fundit, si për shembull, të listës  
10 së dëshmitarëve të datës 29 korrik. Dhe do të thoja që kjo  
11 përbën edhe pjesën më të madhe të dokumenteve të nxjerra sipas  
12 rregullës 103.

13 Të tjerat kanë -- është një numër dokumentesh të -- një  
14 numër i vogël dokumentesh të cilat i kemi patur në posedim për  
15 një kohë të gjatë por në fakt nuk kishim -- nuk i kishim  
16 veçuar si pjesë e procesit të nxjerrjes.

17 Megjithëkëtë, unë do të thoja që shumica janë dokumente  
18 të dubluara të cilat pala Mbrojtëse i di, për shembull,  
19 informacionet që kishin të bënin me një dëshmitar gjatë një  
20 bisede telefonike, shënimi për të cilat ne i kemi nxjerrë  
21 përpara. Dhe duke i parë se janë të përsëritura në numër prej  
22 çështjes së ngritura dhe ne i kemi nxjerrë këto dokumenta për  
23 ta plotësuar të tërë kuadrin.

24 Pra, si përmbledhje, 102(3) është një numër dokumentash  
25 të cilat ne i kemi nxjerrë në bazë të këtij rregulli por kemi

1 gjetur edhe një numër tjetër dokumentash që i kemi kapur vetëm  
2 gjatë procesit të auditimit që kemi bërë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit, z. Prokuror.

5 Ju përmendët se disa prej këtyre dokumenteve kanë të  
6 bëjnë me një dëshmitar, kështu thatë?

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. Po të dëshironi unë mund  
8 t'ju jap më në hollësi se për çfarë dokumentash bëhet fjalë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Faleminderit, e shoh që ju keni përmendur në listën tuaj të 29  
11 korrikut që bëhet fjalë për një dëshmitar shtesë.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dakord.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por,  
14 kjo ndodhi në fund të korrikut dhe tani po flasim për fundin e  
15 korrikut. Trupi Gjygues po ju pyet se përse është nxjerrë me  
16 dy muaj e gjysëm vonesë. Ju thatë që keni -- si një proces i  
17 auditimit, e keni shpjeguar këtë, megjithatë, ne duam të themi  
18 që duhet të bëjmë komentin tonë që ka kaluar një kohë shumë e  
19 madhe

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E kuptojmë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A  
22 dëshironi të shtoni ndonjë gjë tjetër për sa i përket  
23 rregullës 102(3)?

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse. Ne  
25 kemi një numër dokumentash të tjera të rregullës 102(3). Në

1 goftë se dëshironi të dëgjoni mbi këtë çështje.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Dakord. Kemi parë që keni identifikuar 108 dokumente të cilat  
4 mund t'i nxirrni dhe keni kërkuar leje nëse mund ta bëni këtë  
5 përmes një njoftimi të rregullës 102(3) që është ky në nenin  
6 15 të dosjes 303. Ne duam të dëgjojmë nëse keni disa komente  
7 shtesë. Duam të dëgjojmë nëse keni ndërmend të keni masa  
8 mbrojtta për këto dokumenta përpara se t'i nxirrni ato për  
9 palën Mbrojtëse. Pastaj do t'ja jap fjalën palën Mbrojtëse.

10 Në fakt, do t'ia jap fjalën për të reaguar edhe për  
11 rregullën 103 edhe për materialet e rregullës 102(3), pra  
12 palës Mbrojtëse që t'i bëjë komentet në të njëjtën kohë për të  
13 dyja çështjet

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

15 Ne kemi ulur numrin e materiale që kemi patur në mocionin  
16 me shkrim. Tani kemi 85. Dhe këtë e kemi bërë pasi kemi  
17 shmangur dokumentat e dubluara dhe një numër dokumentesh të  
18 cilat janë nxjerrë përpara. Kështu që shifra tani është 85.

19 Nuk ka nevojë që këto dokumente të kenë masa mbrojtëse në  
20 goftë se këto dokumente do t'i nxirren palës Mbrojtëse apo  
21 nëse ajo kërkon një gjë të tillë.

22 Edhe këto janë dokumente të cilat kanë dalë si rezultat i  
23 auditimit në periudhën e fundit përgatitore.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Pala Mbrojtëse ju e keni fjalën nëse dëshironi të  
2 përgjigjeni.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar  
4 Gjykatëse.

5 Të nderuar Gjykatës, unë nuk mund ta fsheh që unë nuk jam  
6 rehat me këtë pozitë që ka mbajtur pala e Prokurorisë. Dhe kam  
7 ndjesinë që me ndryshimet, me heqjen e disa dëshmitarëve në  
8 këtë pikë kohore apo me shtimin e një dokumenti -- i një  
9 dokumenti, kjo nuk është në rregull. Po të ishte dokument i  
10 ri, dakord, ne do të diskutonim mbi këtë çështje, do të  
11 shprehnim shqetësimet tona. Por, këtu nuk bëhet fjalë për  
12 dokumente të reja. Dhe ndjehem keq, kam një parandjenjë të  
13 keqe lidhur me mënyrën sesi nxirren këto dokumente, sikur nuk  
14 kemi arritur në fund të periudhës paragjyqësore. Sikur bëhet  
15 fjalë për vështirësi të mëdha.

16 Ne tani kemi arritur në periudhën reale, nuk është më  
17 periudhe paragjyqësore. Dhe ne po na detyrojnë që të punojmë  
18 sikur po ecim në rërë e cila rrëshqet gjithë kohën. Ne i  
19 fillojmë hetimet tona në bazë të dokumenteve që janë dhënë dhe  
20 e kuptoni sesa e vështirë që të merren dokumente pikërisht në  
21 këtë fazë të procedurave penale. Ne duhet t'i -- kur i marrim  
22 këto dokument na duhet t'i lexojmë, t'i analizojmë, na duhet  
23 kohë për t'i përkthyer, me qëllim që të mund t'i analizojmë  
24 vetëm me z. Shala dhe në këtë mënyrë të përpigemi të dalim me  
25 vendim më të mirë dhe të arrijmë në përgjigjen më të

1 përshtatshme, të drejtë apo të padrejtë. Nganjëherë ky nuk  
2 është problem. E pranoj, por në të shkuarën jemi përballuar me  
3 një numër të madh vështirësish.

4 Më duhet të kujtoj të gjithë njerëzit, më duhet të kujtoj  
5 faktin që janë rreth 500 dokumente të cilat i janë dhënë me  
6 shumë vonesë palës Mbrojtëse. Ne kemi vështirësi, vështirësi  
7 shumë të madhe me mënyrën se si na janë paraqitur një numër  
8 prej dokumenteve. Dhe të gjithë ne kemi humbur një kohë shumë  
9 të gjatë. Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka humbur shumë  
10 kohë dhe tani e kuptoj që situata po vazhdon të përsëritet.

11 Nganjëherë e pranoj që ky nuk është problem. Nuk është  
12 problem i madh, por nganjëherë na duhet që të bëjmë hetime në  
13 terren pasi kemi marrë informacione të reja dhe nganjëherë --  
14 dhe kjo është situata më e pafavorshme, ne detyrohemi që t'i  
15 rilexojmë dokumentat kur kanë lindur aspekte të reja, si  
16 rezultat i nxjerrjes së një dokumenti të ri.

17 Pra, unë mendoj dhe e them me plot respekt se ka ardhur  
18 koha që t'i japim fund kësaj mënyre të vepruari. Unë mendoj që  
19 kjo situatë nga pikëpamja procedurale duhet parë brenda  
20 kuadrit të një afati i cili tashmë ka kaluar. Tani është koha  
21 të themi "mjaft".

22 Çfarë është gjyqi vetë? Gjyqi nuk mund të jetë një kurth.  
23 Nuk mund të jetë një pritë që na bëhet.

24 Unë nuk e them që këtë dëshiron të bëjë pala e  
25 Prokurorisë. Jo. Por dua ta them qartë që na krijohet

1 përshtypja sikur po ecim në rërën që rrëshqet dhe po humbim  
2 shumë energji duke lexuar, për shkak se na duhet të lexojmë  
3 disa dokumente dhe të rifillojmë disa hetime, pasi ndjesia e  
4 ecjes në rërën që rrëshqet bën që ndoshta të përfundojmë në  
5 kënetë. Këto janë vështirësitë me të cilat përballohem.

6       Është Prokuroria që është motori i procedurave penale.  
7 Ato të cilët nxjerrin një aktakuzë, kërkojnë konfirmimin,  
8 kërkuan arrestimin e z. Shala, i cili ka tashmë 18 muaj në  
9 paraburgim. Dhe tani disa ditë përpara fillimit të kësaj  
10 konference ne marrim dokumente të cilat në fakt nuk janë  
11 dokumente të reja.

12       Nuk duhet ta zgjasë më tej. Shpresoj se e kuptoni shumë  
13 mirë se cili është shqetësimi im. Dhe si përfundim, më duhet  
14 ta nënvizoj që ky problem është një pjesë e një tërësie. Është  
15 një shfaqje e shqetësimeve reale. Është një farë mënyre për të  
16 mos përfunduar nxjerrjen e dokumenteve dhe në fakt edhe për të  
17 ndryshuar mendje, për të ndryshuara bazën reale të çështjes  
18 penale.

19       Nuk dua të shtoj gjë tjetër. Vetëm një gjë. Ne kemi  
20 nxjerrë dosjen paragjyqësore. Nuk ishim të detyruar ta bënim  
21 një gjë të tillë. Por, e bëmë një gjë të tillë sepse deshëm  
22 t'i qasemi kësaj çështjeje në mënyrë profesionale, të nivelit  
23 më të lartë profesional. Dhe ne vendosëm që të ishim të qartë  
24 tërësisht për të shpjeguar se cili ishte qëndrimi ynë në këtë  
25 fazë. Por kemi ndjesinë që Prokuroria po ndryshon diçka. Nuk e

1 di a po kërkojnë të ndryshojnë këndin e strategjisë së tyre  
2 apo të tërë argumentet e tyre por, ekziston kjo mundësi dhe  
3 ndoshta do ta përsëris pak më vonë, pak më në hollësi.

4 Faleminderit.

5 Më duket se z. Aouini kërkon të shtojë diçka.

6 Faleminderit.

7 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit, z. Gilissen.

8 Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.

9 Si shembull për të ilustruar çështjen e rregullës -- e  
10 nxjerrjes së rregullës 102(3) [sipas përkthimit]. Të nderuar  
11 Gjykatës, ju paraqitët që data për nxjerrjen e dokumenteve  
12 ishte data 27 maj. Pas kësaj ne morën një numër shënimesh  
13 lidhur me materiale shfajësuese.

14 Si shembull sesi ka ndikuar kjo çështje, po i referohem  
15 paragrafit 12 dhe nuk do të përmend pseudonimin e dëshmitarit  
16 pasi jemi në seancë publike. Por, për sa i përket nxjerrjes me  
17 numër 87, Prokuroria tha që kjo ishte një çështje për të cilën  
18 ka patur dijeni pala Mbrojtëse. Kjo në fakt nuk është  
19 tërësisht e vërtetë dhe kemi dy shembuj me atë të së cilës  
20 mund të themi që ne i kemi marrë këto informacione të premtën  
21 e shkuar, ndërkohë që korrespondencën për t'i kërkuar  
22 informacion ZPS-së lidhur, me këtë informacion, për sa i  
23 përket këtij dëshmitari dhe për të hetuar, e kemi kërkuar para  
24 shumë kohësh dhe kemi marrë përgjigje negative. Të premtën e  
25 shkuar e morëm këtë dokument si pjesë e dokumenteve

1 shfajësuese.

2 Pra, e gjithë koha dhe burimet që ne i kemi shfrytëzuar  
3 për ta siguruar këtë informacion, të nderuar Gjykatës, kanë  
4 shkuar kot. Ishin këto mocione të cilat do na kishin lejuar që  
5 të siguronim këtë informacion. Këto janë dokumente që duhet të  
6 na ishin nxjerrë me datën 29 korrik ose menjëherë pas sipas  
7 rregullës 103.

8 Kjo do të na kishte lejuar ne si palë Mbrojtëse të mos  
9 harxhonim kohën kot dhe duke kërkuar informacion i cili ishte  
10 i gatshëm dhe i shfrytëzueshëm. Ky është një shembull  
11 ilustrues.

12 Bëhet fjalë -- e njëjta gjë edhe për rregullën 102(3).  
13 Kemi patur mjaft të tilla. A ka ardhur koha të bëhet një  
14 analizë përfundimtare kur kemi patur një afat për të  
15 përmyllur dhe ZPS-ja ka bërë një auditim të dokumenteve. Sot,  
16 bëhet fjalë për 108 dokumente të cilat ne do të duhet t'i  
17 analizojmë për të parë se ku kemi arritur në çështjen tonë,  
18 është argumentet tona dhe për të parë se çfarë ndikimi kanë  
19 këto nxjerrje të vonuara mbi punën dhe ritmet e punës sonë.

20 Faleminderit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit.

23 Z. Prokuror, fjalën e keni ju për t'ju përgjigjur  
24 komenteve.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar



1 Gjykatëse.

2 Të nderuar Gjykatës, çështja e Prokurorisë nuk ka  
3 ndryshuar. Ne kemi vendosur që të heqim disa dëshmitarë, gjë e  
4 cila është tërësisht normale në momentin kur shkon në gjykim,  
5 në mënyrë të tillë që ta kemi më të përqendruar këtë çështje.

6 Sa i takon dokumenteve të reja që kemi shtuar, mendoj që  
7 ndoshta avokati i referohet kërkesës për të ndryshuar listën e  
8 dokumenteve sipas rregullës 102(1)(b). Këto janë të vetmet  
9 dokumente të cilat ne kemi shtuar në prezantimin e çështjes  
10 tonë. Ne kemi kërkuar, të nderuar Gjykatës, dokumente shtesë,  
11 dhe ju shpjeguar pak më përpara arsyen se pse ne dëshirojmë që  
12 këto materiale t'i nxjerrim edhe sipas rregullës 102(1)(b).

13 Dy dokumente kanë të bëjnë me statusin e dëshmitarit në  
14 fund të korrikut. Prokurori gjithashtu shpjegon që ndoshta nuk  
15 synon që t'i përdorë këto dokumente në gjykim, megjithatë ka  
16 vendosur që t'i përfshijë këto dokumente për të dhënë panoramë  
17 e plotë për Mbrojtjen dhe për të qenë sa më përfshirës në  
18 dokumentet që i jep Mbrojtjes.

19 Një dokument i fundit është një raport i cili është  
20 vërtetues i informacionit që njihet për Mbrojtjen. Është  
21 identifikim me anë të fotove ku dëshmitarët identifikojnë  
22 persona të cilët i kanë njohur ndërmjet kryesve të pretenduar  
23 të keqtrajtimit dhe të rrëmbimit. Ne nuk mendojmë që ky  
24 informacion çon në ndryshimin e çështjes. Dhe ne nuk mendojmë  
25 se numri i dokumenteve që kemi shtuar ka qenë i kufizuar.

1 Për sa i përket dokument të 102(3), të nderuar Gjykatës,  
2 që këto janë dokumente që nuk synon Prokuroria që t'i përdorë  
3 gjatë gjykimit. Ne ja kemi njoftuar Mbrojtjes këto sepse jemi  
4 të detyruar ta bëjmë këtë gjë. Janë dokumente të cilat janë  
5 relevante. Nuk janë dokumente me rëndësi thelbësore për  
6 Mbrojtjen e çështjes së palës tjetër, kështu që ata mund të  
7 bëjnë vlerësimin e tyre.

8 Sa i takon rregullës 103, unë nuk jam i sigurt se për  
9 çfarë dokumentesh e kishte fjalën kolegu im avokat. Ai u  
10 tregua i kujdesshëm që të mos përmendte dëshmitarin,  
11 megjithatë, dokumentet që ne kemi nxjerrë, përveç listës së  
12 dëshmitarëve të korrikut, kërkojnë ca kohë që të rishikohen  
13 listat tona për dëshmitarë shtesë edhe pastaj që të gjenden  
14 vendet se ku janë dokumentet. Pastaj kemi pasur edhe verën,  
15 edhe staf të kufizuar, megjithatë ne kemi bërë nxjerrjen e  
16 këtyre dokumenteve në momentin që i kemi gjetur ato dhe i kemi  
17 pasur në disponueshmërinë tonë.

18 Mendoj që ky është fundi i përgjigjes time ndaj kolegëve.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit, z. Prokuror.

21 Avokat, do të bëjmë një tjetër raund. Atëherë, le të  
22 ndajmë. Domethënë, kemi kërkesën për ndryshimin për listën e  
23 prova materiale, çështje të cilën do të doja që ta trajtojmë  
24 pak më pas. Për të qenë në qartë ju nuk po diskutoni këtë gjë  
25 apo jo? Thjesht për ta kuptuar unë.

1 Z. AOUINI: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse, neve po  
2 diskutojmë për nxjerrjen e materialeve të premtën që shkoi, që  
3 është paketa 87. Mund t'ju jap edhe numrin ERN.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,  
5 jo, vetëm doja ta sqaroja këtë gjë në qoftë se flasim për këtë  
6 gjë apo për materiale që ju sapo na thatë.

7 Për mua është e qartë të thuhet që ju jeni kundër shtimit  
8 nga ZPS-ja të 85 dokumenteve, apo jo? Pra shtimi i 85  
9 dokumenteve sipas njoftimit bazuar në rregullën 102(3) edhe në  
10 qoftë se ato mund të jenë me rëndësi thelbësore për mbrojtjen  
11 tuaj. Ky është pozicioni juaj, apo jo?

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse, sepse në  
13 qoftë se janë relevante për neve apo jo, ne na duhet që t'i  
14 shikojmë këto dokumente t'i shqyrtojmë ato. Ajo çfarë po themi  
15 neve është shumë vonë për ne për të diskutuar apo për të  
16 analizuar këto dokumente. Domethënë, çështja që po ngremë  
17 është që vonesa e Prokurorisë është e madhe sepse neve pas 18  
18 muajsh marrim dokumente të cilat duhet t'i kishim marrë që me  
19 27 maj.

20 Ne nuk po themi që nuk duhet t'i marrim këto njoftime  
21 sepse sigurisht që janë të rëndësishme për ne. Por, po themi  
22 që ne jemi vendosur në një pozitë që duhet t'i trajtojmë këto  
23 materiale më vonë se sa ç'duhet t'i kishim trajtuar.

24 Pra, po them që këto njoftime duhet t'i kishin marrë  
25 përpara se t'i ishte kaluar çështja Trupit Gjykses në mënyrë

1 që ne të kishim më shumë siguri lidhur me atë çfarë përmban  
2 çështja. Dhe në mënyrë të tillë që ne të kishim shtjelluar ato  
3 gjëra të cilat ishin përparësi për ne.

4 Parashtrimi tjetër është që informacioni -- materiali i  
5 dhënë nga Prokuroria, dhe në fakt ajo çfarë tha Prokurori nuk  
6 është i qartë në kuptimin që i gjithë materiali është i ditur  
7 për Mbrojtjen. E kundërta është e vërtetë. Ka informacion që  
8 kemi kërkuar nga ZPS-ja dhe përgjigja që kemi marrë nga ZPS-ja  
9 është që ata nuk e kishin këtë informacion ose nuk e kanë  
10 dhënë informacion dhe në fakt këtë lloj informacioni e kemi  
11 marrë të premtën e shkuar.

12 Faleminderit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
14 rregull.

15 Në qoftë se dëshironi, mund t'ju jap edhe një herë fjalën  
16 për të folur, në mënyrë që ta sqarojmë këtë çështje. Nuk është  
17 e qartë për neve në qoftë se do të japim një urdhër me gojë  
18 lidhur me këtë çështje apo në qoftë se do të marrim një vendim  
19 me shkrim.

20 Megjithatë, do t'i lejoj z. Prokuror, që të  
21 kundërpërgjigjeni lidhur me atë çfarë tha Mbrojtja dhe pastaj  
22 do t'ja jap sërish fjalën Mbrojtjes.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Shkurtimisht.

24 Faleminderit shumë e nderuar Gjykatëse.

25 Kur flitet për cenimin apo paragjykimin ne nuk jemi

1 dakord me faktin që duhet të dëshmohet cenimi. Në qoftë se  
2 Mbrojtja duhet të rishikojë materialet dhe në qoftë se  
3 Mbrojtja gjen dokumente konkrete të cilat janë cenuese për të,  
4 atëherë mendoj që ato duhet të bëjnë parashtrimet e nevojshme  
5 dhe analizimet e nevojshëm.

6 Mendoj që është e parakohshme që të flitet për cenim apo  
7 gjykim, kështu që e kundërshtojmë parashtrimin e Mbrojtjes  
8 lidhur me këtë element.

9 Sa i takon rregullës 103 dhe nxjerrjes së materialeve  
10 sipas rregullës 103 është e vështirë që t'i përgjigjem sepse  
11 nuk jam i qartë lidhur me natyrën e informacionit për të cilën  
12 po flet avokati. Ajo që dua të them unë është që informacioni  
13 që ju kemi dhënë atyre ose informacioni i cili është nxjerrë  
14 sipas rregullës 103 lidhur me një dëshmitar dhe jam i sigurt  
15 që për atë e kishte fjalën dhe Mbrojtja, është kryesisht ose  
16 në një masë të gjerë i njohur për Mbrojtjen. Jo në tërësi. Nuk  
17 jam i sigurt nëse flasim për të njëjtin dëshmitar apo jo dhe  
18 është e vështirë për mua që të vazhdohet ky diskutim në  
19 abstrakt.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të  
21 kalojmë në seancë private sepse duam ta zgjidhin këtë çështje  
22 dhe duam të jemi të qartë për palët. Sepse edhe nëse do të na  
23 duhet të japim një vendim me gojë ose vendim me shkrim duhet  
24 të di se çfarë pozicionin kanë palët.

25 Kështu që znj. Sekretare ju lutem na kaloni në seancë

1 private.

2 [Seancë private]

3 [Seancë private teksti i fshirë]

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5 [Seancë e hapur]

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
7 jemi në seancë publike.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
9 Faleminderit.

10 E keni fjalën ju, i nderuar avokat.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar  
12 Gjykatëse.

13 Sa i takon këtij njoftimi, situata është e vështirë për  
14 ne. Ka rregulla dhe ka edhe vonesa. Ne e dimë shumë mirë që  
15 Prokuroria e ka kaluar kohën për këtë njoftim.

16 Ajo çfarë kërkojmë ne është t'ju kërkojmë juve që të  
17 garantoni të drejtën efektive të Mbrojtjes. Është gjithmonë e  
18 njëjta gjë sa i takon të drejtës së Mbrojtjes. Ky është një  
19 argument që avokatët e përdorin gjatë të gjithë kohës.  
20 Megjithatë, mendoj që kjo është një çështje efektiviteti. Pra,  
21 e seancave gjyqësore efektive dhe përdorim i të drejtave tona.

22 Ja u shpjegova dhe thashë që paragjykimi i vetëm që kemi  
23 ose komenti i vetëm që kemi ne është që ne nuk kemi kohë që të  
24 trajtojmë, të analizojmë disa dokumente tani. Është shumë  
25 vonë. Ajo çfarë po kërkojmë ne është që të kemi një garanci të

1 epërsisë së të drejtës së ligjit. Kjo është çështja.

2 E dëgjoj kolegun tim që thotë që është e parakohshme që  
3 të flasësh për paragjykim apo cenim. Kjo çështje ka më shumë  
4 se sa 20 vite që është në hetim. Detyra e Prokurorisë është që  
5 -- ishte 18 muaj më përpara që të nxirrte aktakuzën. Dhe kjo  
6 është natyrë e procedurës dhe për këtë arsye është përcaktuar  
7 një procedurë paragjyqësore. Dhe tani ka ardhur koha që t'i  
8 vendosim kapakun dhe ta mbyllim këtë çështje. Pra, duhet që të  
9 jemi në gjykatë me një çështje të përcaktuar dhe të mos  
10 vazhdojmë që të shtojmë dokumente herë pas here.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më  
12 duhet t'ju ndërpres z. avokat. Domethënë e ngritët çështjen  
13 tuaj e kuptojmë. Në qoftë se keni ndonjë gjë shtesë që doni të  
14 thoni sigurisht që do ju jap fjalën.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mendoj që e kuptoni shumë mirë.  
16 Ky është shqetësimi ynë. Thjesht doja që ta thjeshtoni edhe  
17 një herë këtë shqetësim tonin. Ju faleminderit për vëmendjen.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të  
19 kalojmë tek pika tjetër. Ndërkohë që e lemë pezull pikën e  
20 ZPS-së, dhe ZPS-ja tha që do të ketë mundësi që t'i përgjigjet  
21 kësaj pike pak më vonë.

22 Tani i drejtohem Mbrotjtjes. Ne kemi kërkuar parashtrime  
23 nga Mbrotjtja për hetimet e mëtejshme të çështjes prej jush.  
24 Vërejmë që këto hetime nuk kanë përfunduar ende. Janë ende në  
25 zhvillim e sipër dhe pyesim në qoftë se mund të parashikoni

1 nxjerrjen e provave të tjera. Dua të di nga Mbrojtja në qoftë  
2 se ka konstatime shtesë prej jush. Sigurisht që ne do të  
3 diskutojmë një pjesë të këtyre çështjeve gjatë seancës *ex*  
4 *parte*, në qoftë se zgjidhni të bëjmë këtë gjë, megjithatë  
5 çfarëdolloj gjëje që mund të ndani në seancë publike ne do të  
6 preferonim për këtë gjë, pra, që pozicionin tuaj ta bëni të  
7 qartë në seancë publike me të gjitha kufizimet me të cilat  
8 lidhen me hetimet tuja.

9 Kështu që Avokat Mbrojtës, fjala për ju. Dhe siç e thashë  
10 edhe më sipër, do t'i kthehem pjesëve konkrete të përgatitjes  
11 tuaj në momente të ndryshme të seancës së ditës së sotme.

12 Fjala për ju.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Sigurisht z. Kryegjykatëse. Të  
14 nderuar Gjykatës, më duhet të jem shumë i kujdesshëm lidhur me  
15 këtë pikë. Mund të them në publik dhe dua ta them në publik se  
16 është shumë e vështirë për ne t'ju japim informacion efektiv  
17 lidhur me këtë çështje, në momentin kur Prokuroria nuk e ka  
18 përfunduar ende nxjerrjen e materialeve të veta. Në publik më  
19 duhet të them që i gjithë informacioni që mund t'jua jap,  
20 domethënë, do t'jua jap në seancë publike.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ka  
22 informacion që mund të ndani me ne në seancë private, me të  
23 gjithë ne që janë në pranishëm në sallën e gjyqit? Domethënë  
24 jo *ex parte*?

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
2 sa i takon seancës *ex parte*, atë dua që ta rezervoj për  
3 çështje të cilat ju dëshironi që t'i diskutoni vetëm me Trupin  
4 Gjykues dhe me askënd tjetër.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, mendoj se është më mirë  
6 kështu.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
8 rregull. Kalojmë në seancë private.

9 Znj. Sekretare ju lutem mund të na kaloni në seancë  
10 private.

11 [Seancë private]

12 [Seancë private teksti i fshirë]

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17 [Seancë e hapur]

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike,

19 të nderuar Gjykatës.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

21 terma më të përgjithshme t'i përmbahemi rendit të ditës. Të

22 gjithë duhet ta kemi këtë parasysht.

23 Po. Pika në vijim. Ju kërkua parashtime në lidhje me

24 miratimin e një kornize për trajtimin informacionit

25 konfidencial dhe kontaktin me dëshmitarët.

1 Urdhëroni, avokat.

2 Z. AOUINI: [Përkthim] Më falni që po ju ndërpres. Nuk e  
3 dëgjuam Prokurorin në lidhje me parashtrimet për hetimet e  
4 tyre në qoftë se kanë përfunduar ose jo. Përsëri kërkoj ndjesë  
5 në qoftë se po ndërhyj pa vend.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne ju  
7 kërkuam të dy palëve dhe Avokatit të Viktimave si edhe Zyrës  
8 Administrative informacion për disa pika konkrete. Trupi  
9 Gjykes aktualisht po diskuton temat, që për mendimin tonë  
10 janë të rëndësishme për gjykimin e kësaj çështje. Dhe unë në  
11 paragrafin 3 kam theksuar se ZPS-ja e konsideron të përfunduar  
12 hetimin e saj. Dhe në qoftë se do të ketë hetime, ato do të  
13 jenë të pakta për të sqaruar, qartësuar disa fakte në lidhje  
14 me dokumentet që tashmë i janë nxjerrë Mbrojtjes dhe pastaj  
15 kaluam në dy pika më specifike lidhur me rregullën 103 dhe  
16 rregullën 102(3).

17 Pra, për mendimin tim, nuk ka nevojë ta pyes ZPS-në në  
18 qoftë se do të ketë hetime të mëtejshme sepse për mua është e  
19 qartë se nuk do të ketë hetime të tilla. Por, për Mbrojtjen  
20 mund ta bëj pyetjen qartë.

21 A keni ju për të komentuar diçka z. Prokuror?

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, e saktë është. Nuk bëmë  
23 parashtrime sepse nuk menduam që Trupit Gjykes duhet t'i  
24 jepet informacion i mëtejshme në lidhje me këtë pikë. Sikurse  
25 e thatë edhe ju vetë, ne i kemi përfunduar hetimet, me kushtin

1 që po bëjmë vlerësime të nevojës për hapa hetimorë  
2 përfundimtarë në qoftë se kjo do të duhet në të ardhmen. Ky  
3 është parashtrimi jonë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.  
5 Këtë e pashë. Por atëherë çfarë mund të presim? A ka diçka për  
6 të pritur z. Prokuror? Është një pyetje e hapur në qoftë se ju  
7 thoni po i përfundojmë hetimet?

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Sipas nenit 35 të Ligjit për  
9 DHSK dhe mandatit të ZPS-së ZPS-ja vazhdon të bëjë hetime në  
10 zbatim të mandatit të vet. Rregullorja përcakton kuadrin  
11 ligjor të hetimeve dhe mbledhjes së provave të mëtejshme.

12 Për sa i përket shembujve për atë se çfarë mund të  
13 hetojmë, a mund të kalojmë shkurtimisht në seancë private për  
14 ta diskutuar natyrën e hetimeve të tilla.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.  
16 Të kalojmë në seancë private, znj. Sekretare.

17 [Seancë private]

18 [Seancë private teksti i fshirë]

19

20

21

22

23

24

25

1  
2  
3  
4  
5  
6  
7  
8  
9  
10  
11  
12  
13  
14  
15  
16  
17  
18  
19  
20  
21  
22  
23  
24  
25

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
faleminderit.

Pika F. Kërkuam parashtrime nga palët në lidhje me një vendim kornizë për trajtimin e informacionit konfidencial gjatë hetimeve dhe kontaktit me dëshmitarët që është në fuqi prej një çështje tjetër para kësaj Gjykate dhe mendoj që nuk ka një farë pajtimi midis palëve në lidhje me këtë pikë. Prokuroria është në favor të një kornize të tillë kurse Mbrojtja mendon se për momentin një kornizë e tillë nuk është e domosdoshme. ZPS-ja parashtron se korniza që tashmë është në fuqi duhet të miratohet *mutatis mutandis* edhe në këtë çështje. Mbrojtja nuk e konsideron të domosdoshme miratimin e kornizës së tillë. Ka një marrëveshje midis palëve në lidhje me këtë çështje.

Avokati i Viktimave nga ana tjetër mbështet plotësisht



1 një kornizë të tillë.

2 Tani, Paneli i pyet palët në qoftë se mund t'i dorëzojnë  
3 një kopje të një marrëveshje të tillë *inter partes* me pikat  
4 për të cilat palët kanë rënë dakord.

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Nuk ka një marrëveshje të tillë me  
6 shkrim. Por është marrëveshje si të thuash në mirëbesim. Ne  
7 kontaktuam ZPS-në në fillim të çështjes, në lidhje me listën e  
8 dëshmitarëve apo njerëzit të cilët ZPS-ja i kishte  
9 intervistuar.

10 Prokuroria mund të më korrigjojë në qoftë se e kam gabim.

11 Ne i kemi thënë Prokurorisë se do t'i kontaktojmë ata  
12 përpara se të kontaktojmë me një dëshmitar që duam ta  
13 kontaktojmë dhe mendoj, nëse nuk e kam gabim, që këtë e kemi  
14 bërë në rastin e një dëshmitari.

15 Pra, në terma objektivë bëhet fjalë më shumë për disa  
16 vende që deshëm t'i vizitojmë.

17 Gjithashtu, kemi kontaktuar Prokurorinë në lidhje me  
18 kontaktimin e një personi që nuk është në listën e  
19 dëshmitarëve dhe Prokuroria na i ka dhënë -- faktikisht e  
20 pyetëm Prokurorinë nëse mund të na i jepte të dhënat e  
21 kontaktit të atij personi. Prokuroria tha që do ta kontaktonte  
22 personin në fjalë për ta pyetur në qoftë se mund t'ja jepte  
23 këto të dhëna. Mendoj që personi në fjalë refuzoi dhe  
24 përgjithësisht, pra, bëhet fjalë për kështu lloj bashkëpunimi.  
25 Mënyra sesi ne vazhdojmë punën është rast pas rasti. Pra, në

1 bazë të një marrëveshje, miratim të informacionit, dijenisë së  
2 ZPS-së dhe kjo ka funksionuar deri tani. Prandaj edhe nuk  
3 mendoj që është e nevojshme të ndërlikohen procedurat me një  
4 farë vendimi të tillë kornizë. Mund ta marrim si një model  
5 kornizën e tillë por, t'ja përshtasim nevojave tona. Dhe  
6 gjithashtu mund ta marrim parasysht edhe praktikën deri tani.  
7 Nuk kemi pasur probleme. T'i japim një mundësi atij  
8 bashkëpunimi sepse qëllimi i Mbrojtjes është bashkëpunimi.

9 Në qoftë se ju, si Trup Gjykes, favorizoni një protokoll  
10 më të rreptë ne jemi të gatshëm dhe të hapur për diskutime.  
11 Mund t'i dëgjoni edhe argumentet e të dy palëve sesi duhet ta  
12 zgjidhim këtë pikë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
14 Faleminderit, avokat.

15 A keni ju z. Prokuror në lidhje me këtë diçka për të  
16 shtuar?

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, kishim një marrëveshje  
18 gojore me Mbrojtje se Mbrojtja mund të kontaktonte dëshmitarë  
19 apo viktimë që nuk ishin të mbrojtur në këtë çështje dhe ne  
20 kemi lehtësuar apo mundësuar kontaktin për Mbrojtjen në fazën  
21 hetimore.

22 Megjithatë, me kalimin e procesit në fazën gjyqësore  
23 nxirret më shumë informacion dhe rreziku i ndërhyrjes ndaj  
24 dëshmitarëve bëhet më i madh, si për shembull, me vetë afrimin  
25 e datës së dhënies së dëshmisë.

1 Pra, në këtë fazë ne mendojmë që vendimi kornizë që është  
2 miratuar në çështje të tjera gjyqësore mund të funksionojë dhe  
3 të jetë modeli për mënyrën e kontaktimit të dëshmitarëve në të  
4 ardhmen. Ne, siç thamë, kishim një marrëveshje me Mbrojtjen,  
5 mirëpo, mendojmë gjithsesi se është më mirë që të miratohet  
6 vendimi kornizë nga çështja 06.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
8 Faleminderit.

9 Avokati i Viktimave, ju keni fjalën.

10 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk do t'i përsëris parashtrimet që i  
11 kam bërë me shkrim. Por dua të shtoj vetëm këtë.

12 Mbrojtja ka të drejtë, një marrëveshje e tillë në bazë të  
13 mirëbesimit është, funksionon dhe korniza i përkufizon gjërat  
14 më ngushtë, pra e bën,, për shembull të domosdoshme incizimin  
15 e çdo interviste që do të zhvillohet. Për shembull, midis  
16 njëjës palë dhe një dëshmitari.

17 Unë mendoj se një procedurë jozyrtare mund të funksionojë  
18 siç duhet në qoftë se nuk bëhet fjalë për shembull për ndonjë  
19 person që ka statusin e dyfishtë dëshmitar/viktimë. Pra, në  
20 qoftë se, për shembull, marrëveshja kornizë mund të zbatohet  
21 vetëm për rastet të tilla, atëherë ne nuk kemi kurrfarë  
22 kundërshtimi.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A  
24 keni edhe diçka për të shtuar ju Avokat Mbrojtës lidhur me  
25 këtë pikë?

1           Z. AOUINI: [Përkthim] Në lidhje me intervistimin e  
2   dëshmitarëve dhe këtë parashtrim e kemi bërë edhe me shkrim,  
3   ne nuk kemi ndërmend të intervistojmë dëshmitarë. Për sa i  
4   përket statusit të dyfishtë viktimë/dëshmitarë, është më mirë  
5   të kalojmë në seancë private, për ta adresuar këtë pikë.

6           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të  
7   kalojmë në seancë private.

8                                 [Seancë private]

9                                 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2 [Seancë hapur]

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike,  
4 e nderuar Gjykatëse.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
6 Faleminderit, znj. Sekretare. Tani do të bëjmë një pushim prej  
7 gjysmë ore. Ju kërkohet që të ktheheni në sallë në 11 pa pesë  
8 dhe të vazhdojmë me temën e radhës që është vizita në vendin e  
9 pretenduar të krimit.

10 Atëherë, në rregull, seanca mbyllet për momentin.

11 --- Pauza fillon në orën 10.26

12 --- Seanca rifillon në orën 10.55

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
14 se vini dhe njëherë. Do të vazhdojmë deri në orën 12.30. Ky  
15 është programi që kemi parashikuar për ditën e sotme. Dhe  
16 pastaj do ta ndërpresim dhe do ta rifillojmë sërish në 9.30  
17 nesër në mëngjes.

18 Pika tjetër e rendit të ditës. Vizita në vendin e  
19 ngjarjes sipas rregullit 74 të Rregullores. ZPS-ja, Mbrojtja e  
20 Viktimave dhe Mbrojtja kanë dhënë mendimet e tyre. Palët dhe  
21 Mbrojtësi e Viktimave mendojnë që një vizitë në vendin e  
22 krimit mund ta ndihmonte Trupin Gjygues.

23 ZPS-ja përmend edhe provat e tjera të cilat mund t'i  
24 tregojnë Trupit Gjygues lidhur me vendin dhe shpërndarjen,  
25 vendndodhjen, si të thuash, të vendit të ngjarjes. Pala

1 Mbrojtëse kërkon një vizitë në vendin e krimit dhe propozon  
2 një numër vendesh që duhen vizituar. Mbrojtësi i Viktimave  
3 mendon që kjo mund të ishte me vlerë për Trupin Gjykues, duke  
4 pasur parasysh, që duhet të mbajmë parasysh disa aspekte të  
5 sigurisë dhe të kostos.

6 Do t'ju pyes të gjithëve dhe po e filloj me ZPS-së. A  
7 keni ndonjë sqarim tjetër për të shtuar në këtë pikë?

8 E shoh që ju po pohoni.

9 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Siç e  
10 kemi shpjeguar dhe në mocionet me shkrim, ne besojmë që Trupi  
11 Gjykues do të përfitonte nga një vizitë në vendin e ngjarjes.  
12 ZPS-ja është e mendimit që koha më e mirë për një vizitë të  
13 tillë do të ishte në fund të paraqitjes së provave nga ZPS-ja,  
14 Mbrojtja e Viktimave dhe Pala Mbrojtëse. Dhe për shkak se, në  
15 atë kohë, Trupi Gjykues do të ishte në gjendje më mirë për t'i  
16 kuptuar të tëra provat e paraqitura nga palët dhe  
17 pjesëmarrësit dhe do të ishte në gjendje që ta vlerësonte  
18 këtë.

19 Megjithëkëtë, të nderuar Gjykatës, ne mbajmë parasysh një  
20 numër aspektesh të kësaj vizite përfshirë çështjen e sigurisë,  
21 të kostos dhe logjistikës. Kështu që, ky vlerësim i takon  
22 Zyrës Administrative dhe Udhëzuesit të Punës lidhur me këto  
23 vizita.

24 Ne mendojmë, që edhe në qoftë se argumentet që paraqiten  
25 janë kundër një vizite të tillë, Trupi Gjykues, gjithsesi do

1 të arrijë të kuptojë të tërë situatën përmes dëshmimeve që do të  
2 paraqesë ZPS-ja gjatë të gjithë seancave gjyqësore.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
4 Faleminderit, znj. Prokurore.

5 Mbrojtësi i Viktimave, duhet t'jua jap fjalën juve në  
6 këtë pikë të rendit të ditës dhe pyetja e posaçme që kisha unë  
7 është që ju keni përmendur jurisprudencë të posaçme në këtë  
8 çështje, përse mendoni që kjo çështje penale është kaq e  
9 veçantë që të na detyrojë neve të shkojmë?

10 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk do të thosha asgjë që do ta  
11 bënte kaq të veçantë në këtë lëndë apo në këtë çështje penale.  
12 Ne u kemi paraqitur juve disa komente nga gjykatës të tjerë,  
13 të cilat mund të jenë me vlerë për juve për sa u përket një  
14 vizite të tillë. Ne i kemi dëgjuar mendimet e individit që  
15 është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ajo që ka ndodhur  
16 në këtë çështje dhe që do të japë dëshmi në këtë çështje  
17 penale, ne i kemi komunikuar mendimet e tij. Ai mendon që kjo  
18 do t'ju ndihmonte juve. Dhe e pranon edhe ai vetë që mund të  
19 ketë disa aspekte të sigurisë të cilat ju, të nderuar  
20 Gjykatës, do të duhet t'i merrni parasysh.

21 Pra, ne i kemi bërë parashtrimet tona, shpresoj që i kemi  
22 bërë në mënyrë të qartë dhe shpresoj që çdo gjë të jetë e  
23 gatshme, e qartë për juve.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
25 Faleminderit, Mbrojtësi i Viktimave.



1 Avokati Mbrojtës, Trupi Gjykses ka disa pyetje të  
2 posaçme. Dhe çështja që kemi në këtë moment është nëse  
3 përgjigjen do ta jap në seancë të mbyllur apo private, pasi  
4 pyetjet që kemi për të bërë bazuar mbi parashtrimet tuaja do  
5 të jenë më specifike, pasi bëhet fjalë edhe për çështjen që  
6 keni ngritur edhe për vendin që ju propozoni.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë mendoj që përgjigjet mund t'i  
8 bëj në publik, e nderuar Gjykatëse.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
10 Dakord.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] Siç jeni dakord, ne jemi dakord  
12 mbi vlerën që do të ketë një vizitë e tillë. Do të ishte me  
13 vlerë për Trupin Gjykses. Ne kemi qenë në terren atje dhe kemi  
14 krijuar një pikëpamje krejt të ndryshme nga ajo që krijohet  
15 përmes fotografive dhe vizatimeve. Pra, jam i sigurt që nga  
16 kjo vizitë mund të kuptohen shumë gjëra dhe jam i sigurt për  
17 këtë çështje.

18 Janë dy vende, janë dy çështje të rëndësishme. Vendet që  
19 do të shohim, pra, dy vende të tjera të cilët do të ishte me  
20 interes të vizitohen. Ne mund të paraqesim parashtrimet e  
21 tjera me shkrim, po të dëshironi lidhur me këtë çështje. E  
22 dyta është dhe momenti kur duhet bërë kjo vizitë. Ne mendojmë  
23 që koha më e përshtatshme është që të dëgjojmë argumentet që  
24 paraqet Prokuroria dhe pastaj të bëjmë vizitën përpara se të  
25 fillojë paraqitja e provave dhe dëshmive nga ana e Mbrojtjes.

1 Prandaj thashë që mendimi im mund të jepet në publik. Jam i  
2 gatshëm t'u përgjigjem pyetjeve që mund të keni juve.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
4 Faleminderit, Avokat.

5 Pyetja që unë kam kërkon një përgjigje më specifike, doni  
6 ta bëni këtë në seancë private apo në seancën *ex-parte*. Unë  
7 preferoj që ta bëjmë këtë në seancë private.

8 Megjithëkëtë, jua lë vendimin juve.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po besoj që mund t'i përgjigjemi  
10 në publik.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
12 keni fjalën privatisht.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo. Unë mendoj që mund ta bëjmë  
14 këtë në mënyrë publike.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
16 Dakord. Dua të di pak më shumë se për cilat vende në veçanti e  
17 keni fjalën juve. Ju i bëtë komentet në mënyrë të  
18 përgjithshme, a ka probleme specifike, nëse ka, a ka ndonjë  
19 një çështje më specifike që ju dëshironi të diskutoni me ne, a  
20 ka ndonjë alternativë që ju apo ZPS-ja mund ta shqyrtoni.  
21 Ppra, ndonjë alternativë që do t'i mundësonte Trupit Gjykses  
22 që të krijonte një pikëpamje pak më të qartë lidhur me vendin  
23 e ngjarjes. Pasi është një numër aspektesh që duhet të mbajmë  
24 parasysh neve, përfshirë edhe sa shpejt mund të bëhet një  
25 vizitë e tillë dhe të gjitha aspektet e tjera të logjistikës e

1 kështu me radhë edhe të sigurisë.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, çështja e sigurisë është  
3 aspekt mjaft i rëndësishëm.

4 Por, ne mendojmë që, nëse ju doni të kuptoni zinxhirin  
5 komandues dhe kush e ka pasur këtë në Kukës, ne duam që të  
6 shkoni tek fabrika e metalit në Kukës. Ne, Prokuroria ka  
7 treguar edhe mbi një shtëpi, ku komandanti i Brigadës 128 ka  
8 qëndruar. Dhe ato kanë disa kontakte. Pra, në qoftë se doni të  
9 krijoni një pamje të qartë të zinxhirit komandues do të ishte  
10 me vlerë për të parë se ku ishte kjo shtëpi, distanca ku  
11 ndodhej ajo dhe informata të tjera. E njëjta gjë vlen edhe për  
12 varrezat. Mund të jap informata të tjera në qoftë se dëshironi  
13 por jam i sigurt se për cilat varreza e kam fjalën. Por do të  
14 ishte me vlerë që të kuptohet se në ç' distancë ndodhet, në  
15 ç' gjendje ndodhet e kështu me radhë.

16 Faleminderit.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
18 Faleminderit, Avokat Mbrojtës.

19 Kalojmë atëherë tek pika tjetër, që është pika C, ecuria  
20 e procedurave. Janë shtatë çështje të cilat do i diskutojmë  
21 dhe po i marr me radhë.

22 E para është fillimi i gjyqit dhe fjalët hyrëse. Kemi  
23 marrë parashtrimet nga palët dhe Mbrojtësi i Viktimave në këtë  
24 pikë.

25 Nuk do t'i lexoj të gjitha. Ato janë paraqitur në rendin

1 e ditës. Trupi Gjykues mendon se është e rëndësishme që të  
2 dëgjojmë nëse ka hapa të tjera që duhet të marrin palët dhe  
3 pjesëmarrësit me qëllim që të përgatitemi për hapjen e  
4 çështjes dhe për sa i përket fjalës së tyre hyrëse.

5 Pra, është një formulim pak më i kufizuar sesa  
6 gatishmëria në përgjithësi për fillimin e paraqitjes së  
7 provave -- pra, a ka hapa shtesë që do të bëjnë, që do të  
8 duhet të marrin palët dhe pjesëmarrësit për fillimin e  
9 çështjes?

10 Dhe për sa i përket Palës Mbrojtëse -- po e fillojmë me  
11 ZPS-në. A ka mundësi që të jeni pak më specifik për sa i  
12 përket pikës E. Sa kohë do të doni për fjalën hyrëse dhe dua  
13 të di nëse është për seancën e mëngjesit, e pasdites, e gjithë  
14 ditës.

15 Dhe për sa i përket pikës F, është një numër çështjesh që  
16 kanë të bëjnë me synimin e të akuzuarit për të bërë një  
17 deklaratë pa betim apo jo.

18 Dhe nëse nuk e dini një gjë të tillë, doja të dija se kur  
19 do të mund të na e jepni këtë përgjigje.

20 Së pari do të dëgjojmë nga Prokuroria.

21 Zonja Prokurore, ju e keni fjalën.

22 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
23 Gjykatës. Nuk kemi gjë për t'u shtuar mocioneve tona me  
24 shkrim. Për sa i përket hapave pasues, ZPS-ja do të japë  
25 komente pak më vonë, ne synojmë të kemi një mocion për

1 konstatimin gjyqësor të fakteve të shqyrtuara. Besoj që ky do  
2 të jetë edhe hapi pasues përpara se të fillojë gjyqi vetë.

3 Përpara kësaj, ne jemi të gatshëm që të fillojmë kurdo që  
4 të caktoni datën e fillimit të gjyqit.

5 Faleminderit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mbrojtësi i Viktimave, e keni ju fjalën.

8 Z. LAWS: [Përkthim] Edhe ne jemi gati që të fillojmë  
9 kurdo që të vendosë Trupi Gjygues. Nuk na ka mbetur asgjë  
10 tjetër përveç se të përfundojmë fjalën tonë hyrëse, por do të  
11 jemi të gatshëm që ta bëjmë këtë përpara se të fillojë gjyqi,  
12 kurdo që të jetë data e fillimit të tij.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit, Mbrojtësi i Viktimave.

15 Tani e ka radhën Pala Mbrojtëse.

16 Ju e keni fjalën.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. E para gjë që dua  
18 të them është që jam i lumtur që prokurorët janë të gatshëm që  
19 ta fillojnë gjyqin dhe nuk kanë përfunduar nxjerrjen e  
20 provave. Është një mrekulli që t'i dëgjosh që ata të thonë që  
21 jemi të gatshëm, ndërkohë që ne kemi kohë që kërkojmë shumë  
22 gjëra, gjëra të cilat janë shumë, një numër dokumentesh që  
23 kanë pasoja për Palën Mbrojtëse. Nuk dua të përsëris atë që  
24 thashë në fillim lidhur me këtë çështje.

25 Po është e çuditshme për mendimin tim, Palës Mbrojtëse i

1 janë dhënë dokumente kaq vonë, nga ana tjetër ata thonë që  
2 janë të gatshëm për të filluar. Nga ne çdo gjë varet nga  
3 dokumentet që marrim. Kjo është pika e parë.

4 E dyta, po, ne duam të bëjmë një fjalë hyrëse. Do të  
5 varet nga koha që do t'i vihet në dispozicion apo koha që do  
6 të kërkojë Prokuroria. Në qoftë se ata duan dy orë, për  
7 shembull, ajo do të na krijojë një ide të qartë se për çfarë  
8 do të flasin ata në fjalën e tyre hyrëse, kështu që dy orë do  
9 të jenë edhe për ne të mjaftueshme.

10 Por kam një shqetësim më të madh unë, kolegu im,  
11 Mbrojtësi i Viktimave ka kërkuar dy orë. Kjo është një çështje  
12 delikate. Përfaqësuesit ligjorë nuk janë palë. Ata duhet ta  
13 shpjegojnë këtë çështje dhe në qoftë se kjo çështje, kjo  
14 paraqitje për ta është dy orë, ata duket sikur marrin rolin e  
15 Prokurorit.

16 Unë kam qenë përfaqësues i viktimave në Gjykatën Penale  
17 Ndërkombëtare, në fakt, në çështjen e parë penale në këtë, unë  
18 vetë.

19 Dhe në fund të tre viteve të gjyqit, Trupi Gjykses më dha  
20 vetëm 30 minuta, më vuri 30 minuta në dispozicion për të  
21 shprehur shqetësimet e mia, pra, në fund të gjyqit. Kështu që  
22 kur unë dëgjoj tani dhe e kuptoj dëshirën e tyre për të  
23 mbajtur një fjalë që zgjat dy orë në fillim të gjyqit, është  
24 një kohë shumë, shumë e gjatë. Është një kohë më e gjatë sesa  
25 koha që ka kërkuar vetë Prokuroria. Dhe më duhet të tregohem i

1 kujdesshëm kur them këtë. Por, mbetet e veçantë.

2 Pika e tretë, po, z. Shala dëshiron të bëjë një  
3 deklaratë. Nuk e di nëse do të jetë një deklaratë e shkurtër,  
4 por jam i sigurt që nuk është shumë e gjatë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,  
6 po, ai do të bëjë një deklaratë pa betim, këtë po thoni ju.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, atë po them.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
9 Dakord. Atëhere vendimi për sa i përket kohëzgjatjes së fjalës  
10 hapëse është një vendim të cilin do ta marrë Trupi Gjykses.  
11 Nuk është një çështje të cilën do ta diskutojmë më tutje  
12 këtej. Desha thjesht të dëgjoja nga palët dhe Mbrojtësi i  
13 Viktimave lidhur me synimet e tyre, pra, nuk dua që ta  
14 diskutojmë këtë çështje më tutje në këtë moment.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Dakord.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
17 do të nxjerrim një vendim në kohën e duhur për sa i përket  
18 datës së fillimit të gjyqit.

19 Dhe tani kalojmë në temën e dytë, që është familjarizimi  
20 i dëshmitarëve përpara se të japin dëshmi këtu.

21 Ne e kemi marrë vëzhgimet tuaja lidhur me këtë çështje.  
22 Nuk do të bëj një përmbledhje këtu.

23 Trupi Gjykses dëshiron të dëgjojë nëse keni vëzhgime të  
24 tjera për të bërë lidhur me këtë çështjen e familjarizimit të  
25 dëshmitarëve.

1 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo, ne nuk kemi asgjë për të  
2 shtuar.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
4 Mbrojtja e Viktimave.

5 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi gjë për të thënë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe  
7 Pala Mbrojtëse.

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] Të jemi të qartë me faktin që  
9 jemi kundër informimit në tërësi të dëshmitarëve.  
10 Faleminderit.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
12 Faleminderit.

13 Pika e tretë ka të bëjë me statusin e dyfishtë të  
14 dëshmitarëve viktime. ZPS-ja dhe Mbrojtësi i Viktimave janë  
15 pyetur nëse kanë shkëmbyer informacion përfshirë me ZMMD-në  
16 për të identifikuar se cilët viktime janë edhe dëshmitarë të  
17 ZPS-së. Kemi vërejtur kërkesën e ZPS-së për të kërkuar nga  
18 Mbrojtësi i Viktimave një listë të individëve të cilët kanë  
19 këtë status të dyfishtë. Ne vërejmë që Mbrojtësi i Viktimave  
20 nuk ka kundërshtim për ta paraqitur këtë listë me shkrim për  
21 ta qartësuar situatën. Po kështu vërejmë që Mbrojtësi i  
22 Viktimave nuk kundërshton edhe nxjerrjen e këtij dokumenti për  
23 ZMMD-në.

24 A ka ndonjë gjë që do të shtojë ZPS-ja lidhur me këtë  
25 pikë?



1 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Jo, nuk kemi mocione të tjera.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Mbrojtësi i Viktimave keni gjë tjetër për të shtuar?

5 Z. LAWS: [Përkthim] Në qoftë se Trupi Gjygues e miraton  
6 këtë autorizim, ne mund ta përfundojmë brenda ditës së sotme.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
8 fund të kësaj seance - nuk besoj që do të përfundojmë sot, por  
9 besoj që do të jetë nesër - gjatë ditës së nesërme do të  
10 nxjerrim disa urdhra gojorë dhe ndoshta edhe disa udhëzime dhe  
11 do ta sqarojmë edhe këtë çështje gjatë këtyre urdhrave.

12 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pika  
14 4, që është prezantimi i provave e të dëshmive.

15 ZPS-së i është kërkuar që të japë informata të mëtejshme  
16 lidhur me këtë çështje. Për sa i përket vetë specifikave të  
17 kësaj teme duam që të kalojmë në seancë private.

18 Znj. Sekretare, a mund të kalojmë në seancë private.

19 [Seancë private]

20 [Seancë private teksti i fshirë]

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14 [Seancë e hapur]

15 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
16 jemi në seancë publike.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
18 Faleminderit, sekretare.

19 Z. Prokuror, ne e dimë që ju synoni që të parashtroni  
20 prova dëshmitarësh, aktekspertiza ekspertësh që kanë të bëjnë  
21 me dëshmitë e tyre edhe gjithashtu edhe raportin e një  
22 instituti: Kështu që duam që të na sqaroni lidhur me  
23 procedurën që ju synoni të kërkonit për pranimin e intervistave  
24 në fjalë, në qoftë se juve synoni që të mbështeteni në  
25 aktekspertizat e këtyre dëshmitarëve ekspert dhe pse këta

1 ekspertë nuk janë pjesë e listës së ndryshuar të ekspertëve  
2 dhe cila është procedura që ju synoni të përdorni për të  
3 kërkuar pranueshmërinë e raporteve të institutit dhe të  
4 personit tjetër.

5 Edhe njëherë tjetër Trupi Gjykses vëren që ekspertët që  
6 janë autorë të këtyre aktekspertizave, për momentin, nuk janë  
7 pjesë e listave të ndryshuara të dëshmitarëve.

8 Përpara sesa t'ju jap fjalën z. Prokuror, Trupi Gjykses  
9 dëshiron të kujtojë që rregulla 149 e Rregullores e parashikon  
10 që ekspertët mund të thërriten vetëm atëherë kur palët janë  
11 dakord me këtë. Në qoftë se palët nuk janë dakord atëherë nuk  
12 mund të jepet pranueshmëria për ekspertin për të dhënë  
13 dëshminë e tij në Gjykatë.

14 Fjala për juve, Prokuror.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar  
16 Gjykatëse. Do të mundohem që të trajtojë të gjitha çështjet e  
17 ngritura nga Trupi Gjykses.

18 Sa i takon pikës së parë, propozimin për dorëzimin e  
19 aktekspertizës në pajtim me rregullin 149, arsyeja për këtë  
20 është se ne nuk kemi marrë ndonjë kundërshtim në pajtim me  
21 paragrafin 2 të rregullit, pas nxjerrjes së materialeve. E  
22 kuptojmë që është në të drejtën e Trupit Gjykses për të  
23 vendosur. Dhe në këtë aspekt, ne jemi të gatshëm që t'i  
24 kërkojmë dëshmitarit që të japë dëshmi përpara Trupit Gjykses.

25 Një moment ju lutem, të nderuar Gjykatës, ne duhet që të

1 shohim Dëshmitarin 146 për të ardhur për të dhënë  
2 aktekspertizën e tij. Dhe ne e kemi shqyrtuar mundësinë e  
3 aktekspertizës së tij dhe do kërkojmë që raporti i tij të mund  
4 të konsiderohet si raporti i një eksperti, sepse ky është një  
5 raport që mbështetet kryesisht në mendimin e tij prej  
6 eksperti.

7 Kështu që, ne kërkojmë pranimin e këtij raporti  
8 mbështetur në të njëjtën rregull siç është vepruar dhe në një  
9 çështje tjetër.

10 Sa i takon faktit që dëshmitari nuk është pjesë e listës  
11 së dëshmitarëve të ZPS-së, ne jemi të gatshëm që ta ndryshojmë  
12 listën e dëshmitarëve në qoftë se Gjykata dëshiron që ne ta  
13 bëjmë këtë gjë. Por, ne, për momentin, nuk kemi vendosur që ta  
14 shtojmë atë në listë si dëshmitar, por kemi dhënë indicie në  
15 parashtrimet tona që do synonim që t'i përfshinim ata. Por, në  
16 qoftë se Trupi Gjykues mendon që ne duhet që t'i përfshijmë  
17 ata në listën e ndryshuar të dëshmitarëve, jemi të gatshëm që  
18 të ndryshojmë listën e dëshmitarëve, t'i përfshijmë ata në  
19 këtë listë dëshmitarësh.

20 Nuk e di në qoftë se ka ndonjë gjë tjetër që nuk e  
21 trajtova apo në qoftë se ju përgjigja të gjitha pyetjeve të  
22 bëra prej jush, e nderuar Gjykatëse.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo  
24 çfarë kuptova unë është që ZPS-ja është e gatshme që të shtojë  
25 dëshmitarë të ndryshëm si dëshmitarë ekspertë në listën e



1 dëshmitarëve të ZPS-së në mënyrë të tillë që të ndjekë  
2 procedurë e parashikuar në rregullin 149 në qoftë se Trupi  
3 Gjykues dëshiron që ata të paraqiten përpara Trupit Gjykues,  
4 që të jenë në sallë e gjyqit.

5 Këtë thatë?

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, e saktë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, e  
8 mbajta shënim, ky është pozicioni i ZPS-së.

9 Mbrojtja. Ju lutem, Avokati Mbrojtës.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë jam i lumtur, jam i kënaqur  
11 me përgjigjen e Prokurorisë. Nuk di në qoftë se ka ndonjë gjë  
12 për të shtuar. Mbase mund të shtoj vetëm një gjë. Ato raporte  
13 do jenë pjesë e debatit. Dhe siç e dini, ne do kërkojmë  
14 ekspertë që të shikojnë këto raporte, ka shumë gjëra dhe  
15 prandaj ne kemi kërkuar që të jepet një listë më e plotë e  
16 këtyre dëshmitarëve. Në qoftë se Prokuroria dëshiron që t'i  
17 marrë në pyetje këta dëshmitarë, ky si veprim mirëpritet nga  
18 ne.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit, Avokat Mbrojtës.

21 Z. Prokuror, doni të shtoni diçka?

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, neve do  
23 t'i thërrasim dëshmitarët në qoftë se na kërkohet nga Trupi  
24 Gjykues, por mbajmë pozicionin që dorëzimi i raporteve të tyre  
25 është i mjaftueshëm.

1 Neve dëshirojmë gjithashtu që të kërkojmë provën e  
2 vdekjes së viktimës, pra, Prokuroria do të provojë vdekjen e  
3 viktimës përkatëse të pretenduar. Dhe do ketë prova të tjera  
4 të drejtpërdrejta të viktimës së pretenduar në këtë çështje,  
5 pa u mbështetur në raportin e ekspertit, në aktekspertizën e  
6 ekspertit.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
8 rregull.

9 Tani le të kalojmë tek disa parashtrime të tjera me  
10 shkrim që kemi marrë në të njëjtën temë.

11 Mbrojta e Viktimave ka kërkuar që të bëjë parashtrime  
12 lidhur me paraqitjen e provave dhe pikëpamjet dhe shqetësimet  
13 e viktimave që marrin pjesë në proces gjyqësor.

14 Përveç parashtrimeve me shkrim, Avokati i Mbrojtjes,  
15 Trupi Gjygues ka pyetjet e mëposhtme për ju. Ju lutem mbani  
16 parasysh që jemi në seancë publike, kështu që, ju lutem, na  
17 thoni në qoftë se mendoni se është e nevojshme që të kalojmë  
18 në seancë private për të shtjelluar më tej ndonjërin prej  
19 këtyre pyetjeve.

20 Së pari, në këtë fazë a mund të na thoni në qoftë se  
21 synoni që të thërrisni ndonjë dëshmitar? Kjo është pyetja e  
22 parë.

23 Së dyti, a mund të na qartësoni se cili është qëllimi  
24 konkret që kërkon që të thërritet një psikolog klinik i  
25 specializuar në traumë? E kemi një ide po dua që të jeni më

1 konkret.

2 A mendoni që do të dorëzoni ose synoni që të dorëzoni  
3 aktekspertiza të tjera të cilat kanë të bëjnë me dëmin që  
4 pretendohet që të jetë vuajtur nga viktimat që marrin pjesë në  
5 procese gjyqësore?

6 Dhe, kjo në fakt, nuk është se ka të bëjë shumë me  
7 provat, por ka të bëjë me një temë tjetër të rëndësishme dhe  
8 që lidhet me çështjen në shqyrtim. Duam t'ju pyesim në qoftë  
9 se juve synoni që të bëni kërkesa për zhdëmtime përfshirë këtu  
10 dhe kompensimin që të shqyrtohet nga Trupi Gjyqësor në rast se  
11 merret një vendim fajësie?

12 Më pas, do të diskutojmë për çështjen e referimit,  
13 domethënë, në qoftë se duhet të jetë Gjykata në Kosovë apo jo  
14 dhe, në qoftë se proceset e zhdëmtimit duhet që t'i shqyrtojmë  
15 në të njëjtën kohë ose paralelisht me çështjen e shqyrtim.

16 Këto janë pyetjet që janë drejtuar juve, i nderuar Avokat  
17 i Viktimave.

18 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

19 Përgjigja që kemi dhënë në paragrafin 16 të parashtrimeve  
20 tona me shkrim nuk synohet që të jetë e kriptuar në mënyrë të  
21 panevojshme, por Trupi Gjyqësor do të dëgjojë prova nga shumë  
22 dëshmitarë, të cilat mund të dalin të nevojshme për neve për  
23 të thërritur në varësi të çështjes që do të zhvillohet nga  
24 Prokuroria. Pra, pozicioni ynë është që ka shumë pak gjasa që  
25 ne të mund të thërrasim dëshmitarë të tjerë të zakonshëm, që

1 nuk janë ekspertë, pasi të kemi dëgjuar çështjen, siç do të  
2 zhvillohet ose siç çdo të paraqitet nga Prokuroria.

3 Sa i takon pyetjes që ka të bëjë me psikologun klinik,  
4 personi që kemi në mendje ne është një person i cili ka dhënë  
5 dëshmi në proces gjyqësore ndërkombëtare lidhur me dëmtimin,  
6 me dëmin e shkaktuar dhe ne do të mbështetemi në këtë temë.  
7 Kjo ka të bëjë me një individ.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ky  
9 është informacion që dëshiroja të merrja, pra, është  
10 informacion i cili lidhet në mënyrë konkrete me një individ.

11 Z. LAWS: [Përkthim] Po, me një individ lidhet. Ndoshta  
12 është më mirë që të mos jap më shumë hollësi se kush është ky  
13 person në këtë fazë, megjithatë mendoj që jemi në një linjë,  
14 nënkuptojmë të njëjtin person.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
16 Faleminderit. Faleminderit për shpjegimin.

17 Z. LAWS: [Përkthim] Sa i takon raporteve të ekspertit,  
18 domethënë në përgjigje të pyetjes ë radhës, përgjigja për këtë  
19 është jo.

20 Sa i takon kërkesë për zhdëmtim, përfshirë këtu edhe  
21 kompensimin, përgjigja për këtë pyetje është po.

22 Ne do ndjekim të njëjtin proces si në çështjen 5, kështu  
23 që do të ishte e drejtë për neve që të shtonim çështjen e  
24 zhdëmtimit edhe sa i takon kësaj çështjeje gjyqësore, kështu  
25 që besojmë që do të ishte mirë që Trupi Gjyqës t'i jepte

1 udhëzime lidhur me zhdëmtimet dhe mendojmë që është më mirë që  
2 të prisnim për shpjegimet e Trupit Gjykues lidhur me këtë.

3 Pra, përgjigja e kësaj pyetjeje është po, por është një  
4 temë e gjerë dhe shpresojmë që të kemi mundësinë që ta  
5 shtjellojmë atë më tej gjatë procedurës gjyqësore.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
7 Faleminderit, Avokat i Viktimave. Faleminderit për përgjigjet  
8 e dhëna.

9 Mbrojtja, ju lutem, a dëshironi që të komentoni lidhur me  
10 ndonjë prej përgjigjeve të marra?

11 Z. AOUINI: [Përkthim] Po, faleminderit, e nderuar  
12 Kryegjykatëse.

13 Sa i takon temës së thirrjes së dëshmitarëve, ndoshta i  
14 vetmi koment që mund të bëjmë ne është që, të nderuar  
15 Gjykatës, ju duhet të shikoni çështjen e statusit të dyfishtë  
16 të dëshmitarëve të viktimave dhe nxjerrjes së identitetit të  
17 viktimave për Mbrojtjen. Siç e tha kolegu im i nderuar, do  
18 thosha që duhet që të kuptohet konteksti. Në përgjithësi ne  
19 mund të themi që Mbrojtja është kundër mbivendosjes së  
20 provave.

21 Një tjetër gjë që do të doja, që t'i kthehesha, është  
22 prania e viktimave pjesëmarrëse në proces gjyqësor dhe e dimë  
23 që vendimi do të merret prej jush, të nderuar Gjykatës, dhe ju  
24 po shqyrtoni në parashtrim të protokolluar që ka të bëjë me  
25 viktimat pjesëmarrëse. Dhe ne do të kufizohemi tek

1   parashtrimet që kemi dërguar dje, thjeshtë, për ju për të  
2   kuptuar që kjo nuk do të ishte praktike në qoftë se identiteti  
3   i viktimave nuk i bëhet me dije Mbrojtjes.

4           Sa i takon ekspertëve ose sa i takon pikërisht psikologut  
5   klinik, sigurisht, që do presim që të marrim më shumë  
6   informacion për sa i takon këtij eksperti për të dhënë  
7   përgjigjen tonë. Dhe sa i takon dëmtimit, zhdëmtimit,  
8   kompensimit, udhëzimet apo korniza që do të përcaktoni ju, në  
9   përputhje me atë çfarë ka bërë Gjykata Ndërkombëtare Penale  
10   apo institucione të tjera të ngjashme, do të duhet që ta  
11   mendojmë këtë çështje dhe vendimi ose qëndrimi i Panelit ose  
12   Trupit Gjykues do të na ndihmonte neve për të thënë sesa me  
13   vend janë çështjet e zhdëmtimit dhe të kompensimit. Ne jemi të  
14   hapur për të gjithë faktorët e mundshëm, megjithatë parimi  
15   duhet të jetë që parashtrimet nga Mbrojtja e Viktimave nuk  
16   duhet të vendosë një barrë të tepërt ose të shumtë mbi  
17   procesin gjyqësor, nuk duhet të jenë jo në proporcion me  
18   procesin gjyqësor.

19           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20   Faleminderit, Avokat Mbrojtës.

21           Lidhur me pyetjen e Trupi Gjykues sa i takon  
22   aktekspertizave që pretendohet që të jenë vuajtur nga viktimat  
23   në këtë proces gjyqësor.

24           Dëshiroj që të bëj një koment lidhur me këtë. Unë nuk e  
25   përmenda këtë raport në kuadrin e procesit për zhdëmtimin,

1 sepse do të duhet që të vendoset lidhur me këtë element. Se  
2 kjo është një çështje tjetër dhe thjesht doja të dija mendimet  
3 tuaja, pikëpamjet tuaja lidhur me këtë.

4 Është paraqitur dhe në çështjen 05 si propozim i pjesës  
5 së procedurës penale për të vërtetuar në qoftë se është  
6 shkaktuar dëm mbi palët e pretenduara në atë çështje.

7 Dhe këtu nuk bëhet fjalë vetëm thjesht për zhdëmtim, për  
8 qëllime zhdëmtimesh, po bëhet fjalë edhe për procese penale.  
9 Dhe prandaj, për këtë arsye, brenda kësaj kornize unë i bëra  
10 pyetjen, që bëra pak më përpara, për Avokatin e Viktimave.  
11 Megjithatë, jam dakord me ju që mund të jetë me rëndësi për  
12 procese gjyqësore të mundshme zhdëmtime të mëvetësishme.

13 Dhe për këtë arsye, domethënë, kjo pyetje u bë përpara  
14 pyetjes në qoftë se Mbrojtja e Viktimave do të kërkojë  
15 zhdëmtim.

16 Pra, thjeshtë doja që të sqaroj që bëhet fjalë për një  
17 qëllim të dyfishtë.

18 Ky është sqarimi që doja të bëja në këtë pikë.

19 Avokat i Viktimave, a dëshironi që të shtoni diçka tjetër  
20 në kundërpërgjigje të asaj çfarë u tha nga Mbrojtja?

21 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, faleminderit.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I  
23 mbajtëm shënim shqetësimet tuaja.

24 Avokat Mbrojtës, juve ju kërkua që të jepni informacione  
25 të mëtejshme dhe më konkrete lidhur me çështjen e Mbrojtjes.

1 Ju konfirmuat që, sigurisht, që do të prezantoni, do të  
2 paraqisni një çështje përpara Trupit Gjykues. Dëshiroj të di  
3 pak më tepër por vendosëm që shtjellimin e mëtejshëm do ta  
4 bëjmë në seancën *ex parte*, kështu që për momentin do ta lë  
5 këtu diskutimin.

6 Kalojmë tek pika 5, që është rendi i paraqitjes dhe  
7 çështje të cilat kanë të bëjnë me marrjen në pyetje të  
8 dëshmitarëve.

9 Kam një pyetje, lista e dëshmitarëve a është  
10 përfundimtare dhe sa i takon mënyrës së marrjes në pyetje të  
11 dëshmitarëve -- kjo është një pyetje që i drejtohet ZPS-së.  
12 Një pjesë e përgjigjes është dhënë, në kuptimin që e kuptoj që  
13 lista, me ç' thatë juve, është përfundimtare por varet nga  
14 dëshmitarët ekspertë, nëse është përfundimtare apo jo.

15 Megjithatë dua t'jua lë fjalën juve që të na sqaroni më  
16 tepër dhe të na jepni përgjigje për këtë pyetje.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E keni kuptuar drejtë, e  
18 nderuar Gjykatëse. Duhet dhe një parashtrim tjetër të bëhet  
19 prej nesh por ne dëshirojmë që të bëjmë paraqitjen e provave  
20 në mënyrë të drejtpërdrejtë përpara Gjykatës.

21 Megjithatë, pas komunikimit të kohëve të fundit me disa  
22 prej dëshmitarëve, është e mundur që ZPS-ja të kërkojë  
23 dëshminë e dhënë nga një ose më shumë prej këtyre dëshmitarëve  
24 përmes videokonferencave dhe kjo është në përputhje me  
25 rregullin përkatës të Rregullores.



1 Kjo është thjesht sa për të informuar Trupin Gjykues.

2 Ne jemi të përgatitur që të japim me kalimin e kohës, në  
3 një të ardhme të shpejtë, një përgjigje më konkrete lidhur me  
4 këtë çështje.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Faleminderit, z. Prokuror.

7 Edhe një pyetje tjetër, ju lutem. A mund të konfirmoni që  
8 rendi i dëshmitarëve në listën e dëshmitarëve është rendi  
9 sipas të cilës ZPS-ja do t'i marrë në pyetje dëshmitarët?

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, deri në masën që konfirmimi  
11 mund të jepet në këtë fazë po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
13 rregull.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Megjithatë, mund të duhet që të  
15 bëhet ndonjë rregullim i vogël.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
17 Faleminderit. Është mirë që e përmendet dhe këtë gjë. Pra, kjo  
18 është diçka e cila mund të nxirret edhe nga parashtrimet,  
19 megjithatë kjo është një çështje e cila na ndihmon edhe sa i  
20 takon planifikimeve.

21 A kemi ndonjë konstatim tjetër shtesë?

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa i  
24 takon pikës 5, Avokati i Viktimave, a ka ndonjë parashtrim  
25 shtesë lidhur me këtë pikë?

1 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë tjetër për të  
2 shtuar, e nderuar Gjykatëse.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
4 mirë.

5 Për Mbrojtjen, dëshiroj t'ju pyes që të na jepni  
6 parashtrime shtesë, në qoftë se keni, lidhur me këtë pikë. Nga  
7 ajo çka kemi diskutuar deri tani, rendi i dëshmitarëve tuaj,  
8 pra, në çfarë rendi do t'i merrni në pyetje dëshmitarët, është  
9 një pyetje shumë e hershme për t'u bërë tani. A mendoni që  
10 renditja në listën e përkohshme të dëshmitarëve tuaj do të  
11 jetë renditja që do respektoni?

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

13 E keni kuptuar drejt, është e parakohshme për neve për të  
14 dhënë një përgjigje. Por qëllimi është fillimisht që të  
15 plotësojmë listën dhe pastaj të përcaktojmë rendin në të cilën  
16 do të pyeten dëshmitarët. Do t'ju japim një përgjigje lidhur  
17 me këtë kur të vijë koha.

18 Megjithatë, në qoftë se doni që ne të japim më shumë  
19 sqarime, mbase më vonë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
21 [Mikrofoni është i fikur].

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Ne kemi kundërshtim të fortë dhe  
23 kategorik për të paktën njërin prej mënyrave të përmendura nga  
24 ZPS-ja, lidhur me zbatimin e dispozitës së parashikuar në  
25 rregullin 145, nuk do them më shumë se kaq, që ka të bëjë me

1 listën e dëshmitarëve.

2 Ju kërkoj ndjesë, por po mundohem që të jem i kujdesshëm,  
3 se po mundohem që t'i jap parashtrimet e mia në seancë të  
4 hapur. Kjo është në përputhje me temën e përgjithshme të  
5 përmendur nga z. Gilissen që në fillim fare të seancës.  
6 Sigurisht, që do të bëjmë parashtrime me shkrim lidhur me këtë  
7 pikë, por ne mendojmë se kjo është një çështje e rëndësishme  
8 paraprake të cilën duhet ta diskutojmë dhe për të cilën duhet  
9 të vendosim përpara se të kalojmë në proces gjyqësor për të  
10 ditur se cili është drejtimi që do të marri ne. Kjo ka pasur  
11 një ndikim shumë të madh mbi përgatitjet e Mbrojtjes,  
12 tërheqjes së dëshmitarëve. Ndryshimi i mënyrës së marrjes në  
13 pyetje të dëshmitarëve ka një ndikim të jashtëzakonshëm mbi  
14 punën që ka bërë Mbrojtja për javë e muaj të tërë në mënyrë që  
15 të përgatisë çështjen e vetë dhe modalitetet ose mënyrën e  
16 paraqitjes së çështjes përpara Trupit Gjyqësor.

17 Në qoftë se dëshironi që mund t'ju japim më shumë  
18 hollësi, sigurisht, që mund t'ju japim ato, por këtë mund ta  
19 bëjmë vetëm në seancë private. Mesazhi i përgjithshëm është  
20 ky, duhet që të shikoni rrethanat konkrete të secilit  
21 dëshmitar përkatës për të përcaktuar se cila është më e mirë  
22 në interes të drejtësisë, sa i takon mënyrës së dëgjimit të  
23 dëshmitarëve të tyre ose krahasimi është me çështjen e  
24 përgjithshme, po gjithashtu edhe disponueshmërinë e provave  
25 për tema të caktuara.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
2 Avokat, propozoj që, në mënyrë që të jeni më konkret, të  
3 kalojmë në seancë private. E kuptoj përmbledhjen që bëtë,  
4 megjithatë do të ishte mirë që të kalojmë në seancë private në  
5 mënyrë të tillë që ta shtjellonim më mirë idenë tuaj.

6 Do preferoja që të mos kalojmë në hollësi, se nuk është  
7 ky momenti për t'u futur në hollësi. Megjithatë jam e  
8 interesuar që të dëgjojë konstatimet tuaja, shqetësimet tuaja  
9 sa i takon mënyrës apo modalitetit të marrjes në pyetje pa u  
10 futur në shumë hollësi.

11 Znj. Sekretare, a mund të kaloni në seancë private, ju  
12 lutem.

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13 [Seancë e hapur]

14 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Faleminderit.

17 Pika 6 e rendit të ditës ka të bëjë me provat jogojore.

18 Paneli vëren synimin e ZPS-së për të kundërshtuar

19 pranueshmërinë e tre dokumenteve, në qoftë se Mbrojtja do të

20 kërkojë pranimin e tyre si prova sipas rregullit 138 të

21 Rregullores. Nuk kemi marrë parashtrime me shkrim nga ZPS-ja

22 në qoftë se do të pajtohet që të merret e njëjta qasje si në

23 rastin 05 për pranimin e provave në momentin kur paraqiten apo

24 kur të merret aktgjykimi.

25 Duam të dëgjojmë mendimin e palëve në lidhje me këtë

1 aspekt.

2 Gjithashtu e kemi parasysh që Mbrojtja do të kundërshtojë  
3 pranueshmërinë e provave jогоjore të nxjerra nga ZPS-ja sipas  
4 rregullit 102, kemi marrë parashtrimet e Mbrojtjes në këtë  
5 drejtim. Dhe gjithashtu parashtrime në lidhje me synimin e  
6 Mbrojtjes për të kundërshtuar sistemin që është në fuqi apo që  
7 ishte në fuqi në çështjen numër 5.

8 Tani ftoj palët dhe Përfaqësuesin e Viktimave të bëjnë  
9 parashtrime shtesë në qoftë se kanë.

10 Znj. Prokurore, urdhëroni.

11 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit. Kërkoj ndjesë që  
12 kemi harruar që të paraqesim mendimin tonë në lidhje me këtë  
13 aspekt.

14 Sidoqoftë, ZPS-ja vazhdon të jetë e qëndrimit se  
15 pranueshmëria e provave jогоjore duhet të -- vendimi në lidhje  
16 me to duhet të merret në momentin e paraqitjes së tyre për  
17 pranim si prova dhe jo në momentin e aktgjykimit. ZPS-ja  
18 udhëzon Trupin Gjykues drejt praktikës tani në funksionim në  
19 çështjen numër 5.

20 Kaq nga Prokuroria.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Faleminderit.

23 Për Mbrojtjen, mos ju duhet ndonjë kohë për t'u  
24 konsultuar? Sepse sikur më shqetëson kjo bisedë, ky konsultim  
25 që bëni.

1 A keni diçka për të shtuar në këtë pikë?

2 I drejtohem Përfaqësuesit të Viktimave.

3 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
5 avokatët e Mbrojtjes, a keni diçka tjetër për të shtuar në  
6 lidhje me këtë aspekt përveç asaj që keni paraqitur në  
7 parashtrimet me shkrim?

8 Z. AOUBINI: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës. Ne do t'i  
9 bëjmë parashtrimet tona përfundimtare në lidhje me të gjitha  
10 provat për të cilat mendojmë se duhet t'u përgjigjemi.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
12 pika numër 7, që është konstatimi gjyqësor në lidhje me faktet  
13 e shqyrtuara në çështjet tjera gjyqësore.

14 A kanë palët, pra, Mbrojtja dhe Prokuroria komente të më  
15 tejshme në lidhje me këtë? Në qoftë se nuk keni atëherë mund  
16 të kalojmë tek pika tjetër.

17 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ne nuk kemi.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
19 Mbrojtja, a keni ju ndonjë parashtrim tjetër të mëtejshëm?

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Faleminderit.

23 Atëherë këto ishin pikat që u vendosën për diskutim në  
24 vendimin në lidhje me konferencën përgatitore për gjykim.

25 Ka dhe një pikë tjetër që dua ta diskutoj dhe kjo është

1 me Përfaqësuesin e Viktimave dhe me Mbrojtjen. Dhe kjo pikë  
2 është si vijon. Në çështjen numër 5, Paneli pat marrë vendim  
3 për të kryer procedurat e zhdëmtimit paralelisht me procedurën  
4 penale, gjithashtu, Paneli mori vendim që në rast të një  
5 vendimi fajësie, viktimat nuk do t'jua referonte gjykatave në  
6 Kosovë, sipas rregullit 22(9) të Ligjit dhe rregullit 167 të  
7 Rregullores. Por në vend të kësaj do të nxirrte një urdhër për  
8 zhdëmtim në përputhje me nenin 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.

9 Dhe ky dokument, ky vendim e ka numrin F000310, i  
10 redaktuar.

11 Ne kemi ndërmend që të ndjekim të njëjtën procedurë edhe  
12 në këtë çështje gjyqësore. Por do të kërkoj mendimin e  
13 Mbrojtjes dhe të Përfaqësuesit të Viktimave.

14 Avokat i Viktimave, a doni të bëni parashtrime në këtë  
15 moment apo doni t'i bëni me shkrim këto parashtrime?

16 Z. LAWS: [Përkthim] Preferojmë që parashtrimet tona t'i  
17 paraqesim me shkrim.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
19 njëjta gjë edhe për Mbrojtjen. A doni që të paraqisni  
20 pikëpamjet e juaja me shkrim apo me gojë?

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Pajtohem me kolegun tim. Do t'i  
22 bëjmë me shkrim.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe  
24 një pikë që u ngrit nga Avokati i Viktimave dhe që duhet të  
25 diskutohet këtu.

1 Ju keni kërkuar nga Trupi Gjykues që të shqyrtojë në  
2 qoftë se do të ishte e përshtatshme që Përfaqësuesi i  
3 Viktimave të ftohej në diskutimet e Panelit me Zyrën  
4 Administrative dhe sidomos në rastin kur trajtohen dëshmitarët  
5 që kanë status të dyfishtë si dëshmitar dhe viktimë. Paneli  
6 është i mendimit se natyra e diskutimeve me Mbrojtjen është e  
7 tillë që nuk kërkon praninë e Përfaqësuesit të Viktimave në  
8 atë seancë.

9 Ky është mendimi i Dhomës.

10 Z. LAWS: [Përkthim] Ju faleminderit.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Atëherë, në këtë moment, do t'i pyes edhe njëherë palët dhe  
13 Përfaqësuesin e Viktimave nëse kanë edhe ndonjë pikë tjetër  
14 për të ngritur në këtë moment.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dua t'i kthehem edhe një herë  
16 Trupit Gjykues në lidhje me atë përgjigjen që nuk e dhashë ma  
17 herët sa i përket nxjerrjes së disa materialeve dhe komenteve  
18 të Mbrojtjes në lidhje me ato nxjerrje materiale.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
20 mund ta bëni. Po ju lutem të jeni sa më i shkurtër meqë nesër  
21 do të nxjerrim urdhra gojorë. Ka mbetur për të diskutuar edhe  
22 pika që u diskutua në seancë private dhe kjo kërkesë mund të  
23 trajtohet edhe nesër.

24 Atëherë, ju mund të vazhdoni edhe tani. Por thjesht desha  
25 t'ju jap alternativë se çfarë preferoni.



1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në rregull. Sa për ta pasur të  
2 plotë dhe të qartë procesverbalin, do ta them këtë në seancë  
3 publike pa nevojë për të shkuar në seancë private. Në faqen  
4 17, rreshtat 19 deri 21 të transkriptit të sotëm, Avokati i  
5 Mbrojtjes tha që kanë kërkuar informacion nga Prokuroria dhe  
6 Prokuroria i ka thënë që atë informacion nuk e ka. Bëhet fjalë  
7 për një shkëmbim të [së] premtës, 14 tetor.

8 Sa për referencë kjo është diskutuar në faqet që i dhashë  
9 të transkriptit.

10 Mendoj që, pa dashje, Mbrojtja këtu ka ngatërruar dy  
11 kërkesa të ndryshme, dy pika të ndryshme, ne nuk kemi thënë që  
12 nuk kemi informacion për të dhënë meqë atë informacion ne  
13 atyre ua kemi dhënë.

14 Më 24 gusht të vitit 2022, Mbrojtja i kërkoi Prokurorisë  
15 informacion në lidhje me çfarëdo të dhënash penale në lidhje  
16 me një dëshmitar që e kemi diskutuar në seancë private. Ne ju  
17 përgjigjëm se do t'i shikonim edhe njëherë bazat e të dhënave  
18 dhe në qoftë se gjenim një informacion të tillë do ta  
19 informonim Mbrojtjen.

20 Mbrojtja më 5 tetor parashtroi pyetjen në qoftë se ky  
21 rishikim i dokumentacionit ka pasur ndonjë rezultat dhe ne ju  
22 përgjigjëm se do t'i ktheheshim me një përgjigje më të plotë  
23 sa më shpejtë që ishte e mundur. Dhe kjo ndodhi më 14 tetor.

24 Në atë datë ne u përgjigjëm se nuk ishim në pozicion për  
25 t'i dhënë një informacion të tillë sepse kjo nuk mund të jepet

1 pa pajtimin e dëshmitarit, pëlqimi e dëshmitarit dhe,  
2 gjithashtu, janë në pyetje dhe masat mbrojtëse që janë lëshuar  
3 nga institucione të tjera.

4 Për sa i përket provave apo informacionit shfajësues, ky  
5 informacion i është nxjerrë Mbrojtjes menjëherë pasi që ZPS-ja  
6 ka përfunduar analizat e veta.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
8 Avokat, a jeni i gatshëm që të përgjigjeni tani në  
9 parashtrimet e Prokurorit?

10 Z. AOUMINI: [Përkthim] Po. Kërkoj ndjesë për gabimin tonë.  
11 Nuk kanë qenë në pozitë që të na japin këtë informacion që ua  
12 kërkuam.

13 Parashtrimi jonë sidoqoftë kishte të bënte me ndikimin e  
14 marrjes së një informacioni të tillë në kryerjen e hetimeve  
15 tona. Ne nuk po sugjerojmë se Prokuroria është sjellë në një  
16 mënyrë të papërshtatshme. Në lidhje me këtë pikë kërkoj ndjesë  
17 edhe njëherë në qoftë se e kemi lanë të kuptohet një gjë të  
18 tillë. Por, thjesht, desha të nënvijëzoj ndikimin që mund të  
19 ketë nxjerrja e informacionit me vonesë në përgatitjen e  
20 Mbrojtjes.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ashtu  
22 i kam kuptuar edhe unë parashtrimet e juaja. Ju faleminderit.

23 Pra, nuk ka parashtrime të tjera të ZPS-së?

24 Përfaqësuesi i Viktimave.

25 Z. LAWS: [Përkthim] Po do të ngre vetëm një çështje që

1 është shfaqur sot dhe nuk kërkon domosdoshmëri të zgjidhet sot  
2 por duhet të zgjidhet në një moment të duhur.

3 Ka të bëjë me diçka që tha Avokati i Mbrojtjes në  
4 kontekst të kohës së kërkuar për fjalën hyrëse.

5 Sa për të qenë i qartë, nuk do të jetë ky fjalim apo  
6 deklaratë hyrëse më e gjatë se dy orë. Shqetësimi që tregoi z.  
7 Gilissen në lidhje me këtë kohë të nevojshme për deklaratën  
8 hyrëse më shkaktoi edhe mua një shqetësim, se nuk dua që z.  
9 Gilissen t'i shkaktohet shqetësim edhe i mëtejshëm.

10 Çfarë dua të them, duke marrë parasysh vendimin mbi të  
11 drejtat e viktimave pjesëmarrëse me një proces të nxjerrë nga  
12 ky Trupi Gjykses në çështjen 05. Është parashtrimi F0052  
13 [sipas përkthimit]. Mund ta shikojmë edhe njëherë këtë vendim  
14 dhe t'i kthehemi kësaj pike edhe nesër.

15 Sepse në një kontekst shumë specifik e kam ndërmend që  
16 t'i drejtohem Trupi Gjykses në fjalën time hyrëse në lidhje me  
17 çështje që kanë të bëjnë me fajësinë apo pafajësinë. Dhe këtë  
18 e bëjmë për disa arsye të vlefshme.

19 Dhe besoj që të gjitha palët do të përfitojnë në qoftë se  
20 e zgjidhim këtë pikë përpara se të filloj gjykimi.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit, z. Avokat.

23 Në kohën e duhur, ky Trup Gjykses do të nxjerrë një  
24 vendim në lidhje me të drejtat e viktimave që marrin pjesë në  
25 procese gjyqësore dhe në atë vendim do të përcaktohet në

1 mënyrë të qartë se çfarë mund të trajtohet në deklaratat  
2 hyrëse. Nuk e kam ndërmend që ta diskutojmë këtë aspekt sepse  
3 udhëzimet në vendimin që përmenda dhe që do japim ne do jenë  
4 të mjaftueshme për Përfaqësuesin e Viktimave. Por, në qoftë se  
5 del ndryshe atëherë, sigurish, që do ta korigjojme. Nuk e  
6 shoh të nevojshme që të diskutohet përmbajtja e atij fjalimi  
7 në gjykim.

8 Por, sidoqoftë ne kemi qenë mjaft të qartë në vendimin  
9 tonë përkatës në atë çështje dhe do të jemi dhe në vendimin në  
10 këtë çështje.

11 Z. LAWS: [Përkthim] Unë do të jem transparent dhe këtë e  
12 kam synim. Por me udhëzimet e Trupit Gjykses edhe mund t'i  
13 ndryshoj pak planet e mia. Në çështjen numër 5, Përfaqësuesi i  
14 Viktimave ju drejtua Trupit Gjykses si në fillim të çështjes  
15 ashtu edhe në përfundim të saj. Kështu që propozoj që të mos  
16 diskutoj më përmbajtjen, por thjesht të jepet një njoftim në  
17 lidhje me atë, që për mendimin tim, është një kornizë e  
18 përshtatshme e aspekte që dua t'i mbuloj në fjalimet e mia.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
20 Faleminderit, Avokat.

21 A keni diçka për të ngritur ju në këtë moment, Avokat i  
22 Mbrojtjes?

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë për të shtuar.  
24 Ju faleminderit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Palët

1 dhe Përfaqësuesi i Viktimave mund me shkrim t'i drejtohen  
2 Trupit Gjykses me kërkesë për konferenca të mëtejshme për  
3 përgatitjen e gjykimit në qoftë se do t'i çmojnë si të  
4 nevojshme.

5 Sot plani është që të punojmë deri në orën 12.30. Do t'ju  
6 tregoj tani se çfarë do të bëjmë nesër.

7 Nesër do t'i kthehemi asaj pjese që nuk arritëm ta  
8 diskutojmë sot, nuk do ta përmend përmbajtjen e asaj pjese por  
9 ju të gjithë e keni të qartë. Trupi Gjykses pastaj do të japë  
10 disa vendime me gojë dhe një pasqyrë të disa vendimeve të  
11 rëndësishme që do t'i nxjerri si Trupi Gjykses së shpejti. Dhe  
12 në qoftë se do të ketë edhe tema tjera për t'u trajtuar,  
13 atëherë do t'i diskutojmë nesër. Sepse ajo që është me rëndësi  
14 është që të gjitha aspektet e rëndësishme që kanë nevojë për  
15 t'u diskutuar të diskutohen.

16 Tani falënderoj palët, Përfaqësuesin e Viktimave,  
17 Përfaqësuesin e Zyrës Administrative që ka qenë këtu i  
18 pranishëm por nuk ka marrë fjalë, për pjesëmarrjen e tyre.  
19 Falënderoj përkthyesit për përkthimin, stenografin dhe ekipin  
20 audiovizual, teknikët audiovizual.

21 Këtu përfundon seanca e sotme.

22 --- Seanca mbyllet në orën 12.23

23

24

25